

# Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. Nr. 12(20). Dhjetor 2007 Çmimi: 50 lekë, 20 dinarë

## “Pa viza në Dibër”

**Kryetari i Bashkisë së Peshkopisë z. Ilir Krosi dhe kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, z. Argëtim Fida kërkojnë heqjen e regjimit kufitar të vizave për shtetasit e dy vendeve. Ndërsa Qeveria Shqiptare e ka bërë një gjë të tillë, shtetasit shqiptarë që kalojnë në Maqedoni paguajnë aktualisht nga 10 Euro për vizë. Në kuadrin e projekteve të përbashkëta të Shqipërisë dhe Maqedonisë për integrimin në BE dhe NATO pritet që edhe Qeveria Maqedonase të liberalizojë dhënien e vizave për shtetasit shqiptarë. Të parët që përfitojnë janë Dibranët, të ndarë padrejhtësisht 95 vite më parë...**

FAQE 3



Dogana e Bllatës

**Një tufë urimesh për dibranët dashamirë të “Rrugës së Arbërit”**

Fjalë pa tufa - Nga Naim Plaku Faqe 6-7

**Rruga e Arbërit, ja relacioni teknik dhe preventivi për tre lotet e para**

FAQE 2

**Mbi edukimin estetik në shkollën e mesme**

NGA HAJRI MANDRI  
FAQE 9

**Lutfi Hoxha, aktori dibran i 100 roleve**

Nga Dr. ASTRIT HOXHA  
Mësues i Merituar  
FAQE 11

**Kryesia e Shoqatës “LID” dhe redaksia e gazetës ju urojnë: Gëzuar Vitin e Ri 2008!**

## Hidrocentrali i Skavicës, ministri Ruli takohet me përfaqësues të shoqatës “Për mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi”

Në përgjigje të PETICIONIT të Shoqatës “Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi”, me qendër në Dibër, të datës 29.11.2007, drejtuar Presidentit të Republikës, z. Bamir Topi, Kryetares së Kuvendit, znj. Jozefina Topalli, kryeministrit të Shqipërisë, z. Sali Berisha dhe ministrit të Ekonomisë dhe Energjitikës të Republikës së Shqipërisë, z. Genc Ruli, lidhur me shqetësimin për projektin për ndërtimin e mundshëm të një HEC-i në Skavicë të Kukësit, me pasojë përmbajtjen dhe asgjësimin e gjithë Pellgut të Dibrës, ditën e enjte, datë 13.12.2007 në orën 17.00 u ftua në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Energjitikës dhe u prit në një takim një delegacion i Kryesisë së Shoqatës “Për mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi”, i përbërë nga nënshkruarit e atij peticioni, Z. Nazmi Drizi - Kryetar i Shoqatës, Z. Ali Hoxha - iniciues dhe Kryetar Nderi i Shoqatës; Z. Sadin Përmezha - nënkryetar dhe z. Nazmi Skepi - sekretar i Shoqatës. Në atë takim të cilin e organizoi dhe e drejtoi ministri Genc Ruli, ishin të pranishëm edhe zv.ministri N. Alibali, deputeti i Dibrës Rr. Kaleci, Prefekti i Dibrës, Xh. Seiti, si dhe dy anëtarë të Kryesisë së Shoqatës: Osman Begu dhe Zyber Kaba.

Ajo që duhet theksuar që në fillim është fakti se pavarësisht se nga të dyja palët pati mirëkuptim lidhur me shqetësimin e njëri-tjetrit, është për t'u theksuar dhe evidentuar se ministri Ruli,

fjalën e tij të hapjes e filloi me këtë shprehje:

“Shteti ka logjikën e vet dhe i bën gjërat ashtu sipas asaj logjike”. Më tej sqaroi duke iu drejtuar palës negociuese: “Ju kenit të drejtën të argumentoni pretendimet tuaja...”

Dhe pasi parashtrio një sërë çështjesh të tjera lidhur me mungesën e energjitikës në vend, duke sqaruar se ai nuk është një projekt i ri, por i trashëguar nga qeveritë e mëparshme, që nga koha e monizimit etj dhe se ndërtimi i HEC-it të Skavicës, më tepër ka të bëjë si rregullator për gjithë krahinën e Drinit lidhur me HEC-et e tjera, të Fierzës, etj, si rezervuar për ta, e përfundoi fjalën e hapjes duke theksuar se “Çdo zgjidhje do ta bëjmë me konsultime sipas shkallëve”.

Më pas e mori fjalën z. Nazmi Drizi, Kryetar i Shoqatës, i cili pasi falënderoi ministrin Ruli dhe stafin e tij për organizimin e këtij takimi, ai parashtrio disa argumente të paraqitura edhe në atë peticion, mbi bazën e të cilave populli i Dibrës e kundërshton ndërtimin e HEC-it të Skavicës, duke theksuar se dëmi ekonomik është shumë më i madh se sa fitimi.

I dyti, nga delegacioni i Shoqatës e mori fjalën z. Ali Hoxha, iniciues dhe Kryetar Nderi i Shoqatës, i cili e vuri theksin në argumentet historike dhe etnokulturale të problemit:

“Për mua, dëmi ekonomik qëndron në plan të dytë, në krahasim me dëmin historik, etnokulturore që i shkaktohet kombit, pasi me ndërtimin e

atij projekti përmblytet një herë e përgjithmonë e gjithë Dibra së bashku me varret dhe historinë e saj, - theksoi ai. - Ne nuk kërkojmë “qiçra në hell” siç bëjnë vlonjatet kur kundërshtojnë ndërtimin e një HEC-i në krahinën e tyre, vetëm me pretekstin se ai u dëmtoka atyre biznesin me turizmin. Krejt e kundërta ndodh me projektin e Skavicës, pasi këtu nuk bëhet fjalë për një “dëmtim” mjedisi, por për përmblytjen përgjithmonë nën ujë të të gjithë Pellgut të Dibrës, më saktë zhduket e gjithë Dibra dhe historia e saj. Këtu nuk është fjala thjesht për cenimin e pronës, por fjala është për zhdukjen e vendbanimit të një krahine të tërë, për zhdukjen e kujtimeve historike e të varreve të të parëve, të trashëgimisë shekullore, bile mijëvjeçare, të rrënjëve etnokulturore të një krahine të tërë. Në qoftë se shteti ka me të vërtetë interes kombëtar për ndërtimin e atij HEC-i, atëherë më parë duhet të ndërtojë një Dibër të re, diku ndërmjet Tiranës e Durrësit dhe të gjejë vend edhe për rivarrosjen e eshtrave të varreve qindrvjeçare të të parëve tanë, të cilët kanë dhënë jetën për mbrojtjen e atyre trojeve nga armiqtë e huaj shekullorë dhe vetëm atëherë mund të bëhen negociata, për një gjë të tillë, duke mos harruar faktin se i gjithë populli i Dibrës që shpërngulet duhet të jetë akzioner, me kushtin që pasardhësit tanë të rikthehen përsëri në trojet e të parëve të vet, pas skadimit të afatit kohor”, - përfundoi fjalën Ali

Hoxha.

Më pas, gjithsecili nga të pranishmit shfaqën mendimet dhe argumentet e veta duke plotësuar njëri-tjetrin në atë takim që zgjati prej më shumë se një orë bashkëbisedimi.

Në fjalën e tij të mbylljes, ministri Ruli, ndër të tjera theksoi sa vijon:

“E vlerësoj shumë seriozisht këtë takim. Asgjë nuk do të bëhet pa i vënë në balancë të gjitha gjërat, të gjitha anët e problemit. Do të bëjmë të gjitha vlerësimet, deri tek ambienti. Por do të merret mendimi i shumicës. Asnjëri nuk do të guxonte të ndërmerre veprime të njëanshme. Qëndrime të njëanshme nuk do të mbajmë.”

Pas këtyre fjalëve shpresëdhënëse të ministrit Ruli, takimi u mbyll me mirëkuptim nga të dyja palët dhe me premtimin nga ana e Ministrisë së do të shpësojmë edhe për takime të tjera.

Në fund depozituam tek sekretari edhe disa materiale të botuar kohë më parë në shtypin e përditshëm, me argumentet që kundërshtojnë ndërtimin e një projekti të tillë, si ai i HEC-it të Skavicës, duke sqaruar se në Pellgun e Dibrës nga ujëvarat natyrore ndërtohen rreth 10 HEC-e të vegjël, të cilën prodhojnë aq energji elektrike sa ç mund të ofrojë projekti i Skavicës, në një kohë që ato nuk dëmtojnë fare asnjë pëllëmbë tokë produktive dhe pa cenuar asnjë nga vlerat historike dhe etnokulturore të Dibrës.

Korresp. i “Rruga e Arbërit”

# Rruga e Arberit, ja relacioni teknik dhe preventivi për tre lotet e para

## RELACION TEKNIK MBI OBJEKTIN: NDERTIM RRUGA BULQIZE-BLLATE (BULQIZE-URA CERENECIT)

### LOTI I PARE

Me fondet shtese nga buxheti i shtetit, per vitin 2007, eshte planifikuar fillimi i ndertimit te rruges Bulqize-Ura e Cerencit, Loti1.

Loti1 fillon ne Km 0 ne dalje te qytetit te Bulqizes dhe perfundon ne km 6,9, para Ures se Qytetit.

Pergjithesisht rruga ndjek gjurmen ekzistuese duke bere permiresimet e nevojshme ne planimetri dhe altimetri.

Gjeresia e rruges : (2x3,5)m pjesa kaluese, (2x1,25)m bankina Paketa kryesore e shtresave rrugore do te jete:

- 4 cm asfaltobeton
- 5cm binder
- 8 cm konglomerat bituminoz
- (2x15)cm stabilizant
- (2x15)cm cakull gurore i fraksionuar

Veprat e artit perfaqesohen kryesisht nga tombino rrethore dhe katrore etj.

Disa punime per nje gjatesi rreth 300 ml jane kryer ne vitin 2005.

Projekt-preventivi eshte hartuar ne vitin 2005 nga firma projektuese ITP Tirane.

Punimet do te kryhen konform projektit te detajuar dhe specifikimeve teknike perkatese.

### LOTI I DYTE

Me fondet shtese nga buxheti i shtetit, per vitin 2007, eshte planifikuar fillimi i ndertimit te rruges Bulqize-Ura e Cerencit, Loti2.

Loti2 fillon ne km6,9 para Ures se Qytetit dhe perfundon ne km12 ne drejtim te Peshkopise.

Pjesa e rruges prej ~ km6,9 deri ~km7,44 eshte krejtesisht e re, duke u shmangur nga gjurma ekzistuese ne nje distance rreth 300ml. Ne vazhdim pasi nderpret lumin e Bulqizes me nje ure te re, rruga ndjek pergjithesisht gjurmen ekzistuese ne krahu tjetër te luginës te lumit duke bere dhe permiresime te pjeseshme ne planimetri.

Gjeresia e rruges : 2x3,5m pjesa kaluese, 2x1,25m bankinat Paketa kryesore e shtresave rrugore do te jete:

- 4 cm asfaltobeton
- 5cm binder
- 8 cm konglomerat bituminoz
- (2x15)cm stabilizant
- (2x15)cm cakull gurore i fraksionuar

VEPRAT E ARTIT. Ne km 7,368 eshte parashikuar Ura e Qytetit me HD 2x22m+1x29m mbi lumin e Bulqizes. Ballnat e ures jane parashikuar me themele masive, ndersa pilat te perbera prej dy shtyllave betonarmeje. Mbistruktura parashikohet me trare te parapergatitur e te paranderur dhe solete monolite.

Veprat e tjera te artit perfaqesohen pergjithesisht nga tombino rrethore dhe katrore, etj.

Projekt-preventivi eshte hartuar ne vitin 2005 nga firma projektuese ITP Tirane.

Punimet do te kryhen konform projektit te detajuar dhe specifikimeve teknike perkatese.

### LOTI I TRETË

Me fondet shtese nga buxheti i shtetit, per vitin 2007, eshte planifikuar fillimi i ndertimit te rruges Bulqize-Ura e Cerencit, Loti3.

Loti3 fillon ne km12 dhe perfundon ne km16,925 te Ura Cerencit. Rruga e re vazhdon ne luginen e lumit duke ndjekur pergjithesisht gjurmen ekzistuese, duke bere dhe permiresime sic eshte ai te vendi i quajtur Tre Cezmat nga km14,6 deri te km15,1.

Gjeresia e rruges: 2x3,5m pjesa kaluese, 2x1,25m bankinat Paketa kryesore e shtresave rrugore do te jete:

- 4 cm asfaltobeton
- 5cm binder
- 8 cm konglomerat bituminoz
- (2x15)cm stabilizant
- (2x15)cm cakull gurore i fraksionuar

VEPRAT E ARTIT. Viadukti ne km15,05 perbehet nga tre hapesira, (dy hapesira anesore nga 21m dhe hapesira e mesit 28m).

Gjeresia e ures eshte: 9,2m pjesa kaluese dhe 2 trotuare nga 1,5m seicili.

Veprat e tjera te artit perfaqesohen pergjithesisht nga tombino rrethore dhe katrore, etj.

Projekt-preventivi eshte hartuar ne vitin 2005 nga firma projektuese ITP Tirane.

Punimet do te kryhen konform projektit te detajuar dhe specifikimeve teknike perkatese.

Përgatiti:  
Ing. SHKËLQIM LUSHA

## PREVENTIVI I OBJEKTIT: NDERTIM RRUGA BULQIZE - BLLATE (BULQIZE - URA E CERENECIT)

Loti 1: Km. 0 + 0.00 deri Km. 6 + 900. Gjatesia 6900 ml. ; Siperfaqja 63000 m<sup>2</sup>  
Loti 2: Km. 6 + 900 deri Km. 12 + 0.00. Gjatesia 5100 ml.; Siperfaqja 47000 m<sup>2</sup>  
Loti 3: Km. 12 + 000 deri Km. 16 + 925. Gjatesia 4925 ml. ; Siperfaqja 44700 m<sup>2</sup>

Nr. ZERI	Emertimi i punimit	Njesia	Sasia Loti 3	Sasia Loti 2	Sasia Loti 1
<b>KATEGORIA NR.1 : PUNIMET E DHERAVE DHE PRISHJET</b>					
1	A.1 Germim i Zakonshem	m3	84300	67500	30640
2	A.2 Germim ne Shkemb	m3	200054	70330	50100
3	A.3b Pergatitja e themelit te mbushjes	m2	152000	21000	21000
4	A.5a Formimi i trupit te Rruges me material germimi rrugor	m3	22000	47400	10400
5	A.5b Formimi i trupit te Rruges me material kariere , shtrimi ....	m3	17033	50000	28000
6	A.14 Shkaterrim Betone , Mur tulle e guri	m3	186	308	400
<b>Shuma 1</b>					
<b>KATEGORIA NR.2 : SHTRESAT RRUGORE</b>					
1	C.1a Skarifikimi i shtresave te Asfaltit Ekz.	m2	22300	20000	23000
2	C.2a Material Çakelli mbeturine , ose zhavor, per nenshtrese	m3	9160	10300	13000
3	C.1b Baza me material , çakell gurore i Fraksionuar , 2 x 15 cm.	m3	13400	15000	19500
4	C.1bis Stabilizant me material te thyer 0-31.5 mm , 2 x 15 cm.	m3	13740	14700	19500
5	C.1ba Stabilizant per bankina 0-31.5 mm , t.= 17 cm	m3	1673	1734	2346
6	C.2 Shtrese Konglomerat bituminoz 8 cm. (perfshi kryqezimet dhe vend pushimet)	m2	45500	48000	64000
7	C.3 Binder , 5 cm (perfshi kryqezimet e vend pushimet)	m2	45100	47500	63500
8	C.5b Asfalto beton 4 cm. (perfshi kryqezimet e vend pushimet)	m2	44700	47000	63000
<b>Shuma 2</b>					
<b>KATEGORIA NR.3 : STRUKTURAT E VOGLA , TOMBINOT , MURE MBAJTESE DHE PRITese</b>					
1	B.1a Germim per Struktura ne dhera (0-4.0 - 8.0 m thellesi)	m3	2800	6152	5930
2	B.2a Germim per Struktura ne shkemb (0-4.0 m thellesi)	m3	760	1000	2200
3	B.9a Mbushje me material germimi	m3	132	226	650
4	B.9b Mbushje me material nga Kariertat	m3	250	210	154
5	B.11a Beton themeli klasa 150 + Kallep	m3	594	787	658
6	B.13a Beton themeli klasa 200 + Kallep	m3	125	184	126
7	B.13c Beton Strukturash klasa 300 + Kallep	m3	717	1623	911
8	B.15b Hidroizolim i betonit nentokesor	m2	2100	1620	1250
9	B.17b F.V.Hekuri per Armim	ton	30.83	104	67.14
<b>Shuma Nr. 3</b>					
<b>KATEGORIA NR. 3/A : VIADUKTI NE KM.15 + 050 - L.= 1 X 29 + 2 X 22M</b>					
1	B.1a Germim per Struktura ne dhera (0-4.0 - 8.0 m thellesi)	m3	3158	2349	
	Germim per Struktura ne Shkemb (4.0 - 8.0 m thellesi)	m3	605	410	
2	B.9b Mbushje me material nga Kariertat	m3	350		
3	B.13a Beton Strukturash klasa 200 + Kallep	m3	660	234	
4	B.13c Beton Strukturash klasa 300 + Kallep	m3	686	852	
5	B.13c/1 Trare Beton Arme te Paranderur , klasa 400	m2	876	876	
6	B.15a Membrane hidroizoluese	m2	904	904	
7	B.17b F.V.Hekuri per Armim	ton	109	78	
8	B.17b Pllaka Neoprene ose seismic lamps	cope	78	84	
9	B.19 F.V. e Fugave te deformimit	ml	25	19	
10	B.21 Dalja e drenimit nga soleta e ures	kg	60		
11	B.22 Tuba Kullimi dhe drenimi Dn. 100 mm.	ml	80	40	
<b>Shuma Nr. 3/a</b>					
<b>KATEGORIA NR. 4 : PUNIME NDIHMESE</b>					
1	E.2a Ndertim Mur Gabioni	m3	10	21	9
2	E.3e/b F.V.Tubo B.Arme Ø - 125 cm	ml	20	60	
3	E.3f F.V.Tubo B.Arme Ø - 150 cm	ml	15		28
4	E.9a Parmake	ml	3500	3500	2200
5	E.9b Parmake me Parapet	ml	62	111	91
6	E.10 Shenja Rrugore	m2	35	35	40
7	E.11 Lyerje e shenjave Horizontale	m2	3150	1900	2200
8	E.13 F.V.Gjeotekstil 300 gr/m2	m2	17000	15000	10000
9	F.1 Veshje e shpatinave me bar	m2	30000	30000	18500
<b>Shuma Nr. 4</b>					
<b>KATEGORIA NR. 5 : ZERA SHTESË</b>					
1	H.1a Zhvendosje e linjes elektrike 6 kw	ml	363	120	196
2	H.1b Zhvendosje e linjes elektrike 220 kw	ml	631		610
3	Hapje Seksioni dhe vendosje Tuba Plastik D.=100 mm., per Fibra Optike	ml	4925	5100	6900
4	Vendosje Puseta per kanaline Fibrave Optike , 1.80 x 0.65 x 1	cope	12	12	10
5	F.V.Tuba metalik Ø - 130 mm. per mbeshtetjen e tubit te kabllove optike ne Vepra Arti	ml	200	200	200
<b>Shuma Nr. 5</b>					
Fond Rezerve 5 %					

**KËSHILLI  
BOTUES  
I GAZETËS**

Drejtor: RAKIP SULI. Kryeredaktor: SHAQIR SKARRA.  
Redaksia: Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani,  
Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala,  
ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.  
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: lid\_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin  
e redaksisë dhe Shoqatës "LID".  
Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",  
PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.  
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

# Kryetarët e dy Dibrave kërkojnë liberalizim të vizave

Nga Rexhep TORTE

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë Peshkopi-Shqipëri dhe Argëtim Fida, kryetar i komunës Dibra e Madhe-Maqedoni, deklarojnë se janë të kënaqur me marrëdhëniet ndërkufitare mes Dy Dibrave, me regjimin ekzistues kufitar dhe si e parashikojnë të ardhmen e kësaj zone.

Dibra e Madhe në Maqedoni dhe Dibra e Vogël-Peshkopia në Shqipëri janë dëshmia më e qartë për plagën që ka shkaktuar kufiri i vendosur 95 vite më parë nga Serbia hegjemoniste dhe i miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe nga Konferenca e Paqes në Paris.

Alivanosja shpirtërore, ekonomike dhe kulturore e popullatës së këtyre zonave kufitare për fat të keq po vazhdon edhe kësaj dite, edhe pas 16 viteve të demokracisë. Ky kufi u hap për herë të parë në 9 qershor të vitit 1992. Janë nënshkruar disa marrëveshje për regjimin e vizave, mes tyre edhe Marrëveshja për qarkullimin e vogël kufitar mes dy vendeve me shtrirje deri 10 kilometra e nënshkruar më 15 qershor 2000.

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë Peshkopi, theksoi se: "Bashkëpunimi ndërkufitar mes dy Dibrave, dita ditës, dhe vit pas viti vjen duke duke u forcuar. Kjo jo vetëm në aspektin kulturor por edhe në lëmin ekonomik. Tashmë grantet që po i jep Bashkimi Evropian, kanë për qëllim ta afrojnë sa më shpejt Maqedoninë me Shqipërinë. Janë programe të ndryshme që po na orientojnë me fonde përkatëse për tu afruar dhe për tu zhvilluar edhe ekonomikisht", tha Krosi.

## ME HAPA TË SHPEJTË ZHVILLIMORË

Në aspektin e decentralizimit, përgjegjësitë që kërkon Bashkimi Evropian "na bën që t'i decentralizojmë pushtetin dhe financat, për të ecur me hapa më të shpejtë zhvillimorë në Shqipëri. Ky decentralizim që bëhet nga lartë poshtë, na jep më shumë kompetenca për tu afruar dhe për të realizuar bashkëpunimin më konkret në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta me të cilat po ballafaqohemi. Gjithashtu edhe infrastruktura është në përmirësim e sipër dhe projekti i madh i Rrugës së Arbërit tashmë është futur në agjendën zyrtare të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe po financohen me miliona euro për ta bërë je-



Argëtim Fida, kryetari i Komunës Dibra e Madhe

tik këtë projekt. Pas përfundimit të rrugës Durrës-Tiranë-Kukës, rruga Arbërit është projekt kombëtar i Shqipërisë dhe besoj se shumë shpejt do të jetë i prekshëm dhe real", tha ai.

Sipas tij, në regjimin kufitar ka akoma për të bërë. Kjo faktikisht është e nivelit qeveritar. "Duhet bërë presion edhe nga shqiptarët e Maqedonisë, nga partitë politike dhe deputetët shqiptarë në Maqedoni në drejtim të Qeverisë së Maqedonisë, sepse në këtë drejtim Maqedonia është më shumë pengesë. Qeveria e Shqipërisë i ka bërë hapat e saj në drejtim të liberalizimit të vizave për shtetasit e Maqedonisë që vijnë në Shqipëri. Te Qeveria e Maqedonisë duhet të kërkohej që të bëjë liberalizimin e vizave. Ne kemi ngritur zërin në qarqet e Qeverisë së Shqipërisë që edhe ajo të përdorë mekanizmat e saj ndaj Qeverisë së Maqedonisë për ta bërë sa më shpejt liberalizimin e vizave me Shqipërinë", tha Krosi.

Argëtim Fida, kryetar i komunës Dibra e Madhe-Maqedoni, shtoi se: "Marrëdhëniet ndërkufitare mes dy Dibrave kanë një trajektore rritëse".

## LOBIMET

"Në vendkalimin kufitar Bllatë që u hap gjatë pluralizmit, fatkeqësisht sasia e mallrave që qarkullojnë ende është shumë e ulët, por edhe qarkullimi i



Ilir Krosi, kryetari i Bashkisë Peshkopi

njerëzve nuk është në nivelin e duhur. Fakti se afër gjysmë milion njerëz këtë pikë kufitare e kanë më të afërt për për të frekuentuar Maqedoninë dhe Ballkanin, tregon se sa pak po shfrytëzohet kjo pikë kufitare. Kemi nënshkruar edhe Memorandum mes Dibrës së Madhe, Maqellarës dhe Gjoricës, dhe kemi dërguar letrat përcjellëse e kemi bërë edhe lobimet në shtetet tona përkatëse", tha Fida.

Aktualisht, thotë ai, "proceset kanë avancuar më shumë në Shqipëri, ku Qeveria Shqiptare mori vendim për heqjen e vizave për tërë qytetarët e Maqedonisë, gjë që ende nuk e ka bërë Maqedonia, kështu që shtetasit e Shqipërisë për të hyrë në Maqedoni ende paguajnë nga 10 euro".

Ky vendim, thotë Fida, pengon ekonominë e qyteteve dhe të shteteve tona. Dibra e Madhe si komunë urbane me më shumë se 200 mijë banorë matanë kufirit që Tiranën e kanë shumë larg, do ta kishin më lehtë po qe se u mundësohej të vinin të tregtojnë në Dibrë të Madhe. Ky qarkullim i mallrave dhe njerëzve duhet të jete shumë fish më i lartë. Përveç regjimit të vizave edhe infrastruktura rrugore duhet të përmirësohet.

Unë jam për liberalizim të plotë të vizave. Sepse zbatimin aktual i Marrëveshjes për qarkullimin e vogël kufitar, që nënkupton lejimin dy herë në muaj të shtetasve shqiptarë që ta kalojnë pa pagesë kufirin për të qëndruar 24 orë, është treguar jo efikas dhe i

**ARGETIM FIDA: Dy Dibrat kemi aplikuar së bashku me projekte në organizata ndërkombëtare, gjë që do ta vazhdojmë edhe në të ardhmen. Kemi bashkëpunim të mirë kulturor, sportiv, të historianëve dhe të poezisë. Tani veprojmë si një tim i përbashkët për zhvillimin ekonomik të kësaj krahine, për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, që do të hap perspektiva të mëdha për zhvillimin ekonomik të dy Dibrave e më gjerë.**

**ILIR KROSI: infrastruktura është në përmirësim e sipër dhe projekti i madh i Rrugës së Arbërit tashmë është futur në agjendën zyrtare të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe po financohen me miliona euro për ta bërë jetik këtë projekt. Pas përfundimit të rrugës Durrës-Tiranë-Kukës, rruga Arbërit është projekt kombëtar i Shqipërisë dhe besoj se shumë shpejt do të jetë i prekshëm dhe real.**

ka detyruar që të mos mund të marrin pjesë në ceremonitë komplete në rast dasme apo vdekje që zgjasin disa ditë. Shqipëria dhe Maqedonia janë në një paket për të aderuar në NATO dhe BE.

Dy Dibrat kemi aplikuar së bashku me projekte në organizata ndërkombëtare, gjë që do ta vazhdojmë edhe në të ardhmen. Kemi bashkëpunim të mirë kulturor, sportiv, të historianëve dhe të poezisë. Tani veprojmë si një tim i përbashkët për zhvillimin ekonomik të kësaj krahine, për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, që do të hap perspektiva të mëdha për zhvillimin ekonomik të dy Dibrave e më gjerë.

Ujërat termominerale, rezervat e gjipsit dhe bukuritë natyrore në dy anët e kufirit, janë bazë për shtrirjen e investitorëve të huaj dhe për zhvillim më të hovshëm të biznesit dhe të rritjes së mirëqenies", tha në fund Argëtim Fida.



Maketa e Xhamisë dhe e Sahatkullës

## Dibrë e Madhe, gurthemel për Xhami dhe Sahatkullë

Në Dibrë Kurban Bajrami u festua në mënyrë solemne. Dyzet xhamitë e Myftinisë së Dibrës në qytet dhe në fshatra ishin të mbushura përplot me besimtarë, ku u fal namazi i Kurban Bajramit me mesazhin për dashamirësi, paqe dhe solidaritet mes njerëzve. U bënë homazhe nëpër varreza, vizitat e ndërsjella familjare, therja e kurbanëve dhe shpërndarja e mishit. Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, duke përshëndetur në emër të pushtetit vendor, theksoi se: "Kjo festë e madhe islame bëhet edhe më e madhërueshme, kur në bashkëpunim me Meshihatën e Bashkësisë islame të Dibrës, arritëm një mirëkuptim që të realizojmë një ëndërr të kahmotshme të qytetit tonë, përkatësisht ndërtimin e bulevardit të varrezat e vjetra Dibrës ia hapi arteriet e jetës për të ardhmen. Ky mirëkuptim i gjerë musliman me në myftiun e qytetit në interes të popullatës vazhdoi edhe me vendimin e KK që për këtë zemërgjerësi të qytetarëve tanë edhe komuna të kontribuojë bashkë me myftininë që Dibrës t'i ofrojë edhe një objekt kapital ku qytetarët do t'i predikojnë traditën dhe ritet muslimane. Ky objekt me idetë më moderne arkitektonike do të jetë edhe objekt i arkitekturës tradicionale dibrane të komunitetit musliman, sepse mbi 99 përqind e popullatës është me religjion musliman. Kjo Xhami dhe kjo Sahatkullë me pozicionin që ka do të jetë e dukshme dhe do të rrezatojë kulturën tonë për secilin kalimtar nga Shkupi, Struga dhe Shqipëria".

Mr.Ef. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës, shtoi se: "Ar-

ritëm të realizojmë një bashkëpunim tejet serioz me perspektivë ideale për qytetin e Dibrës. Kjo Xhami dhe kjo Sahatkullë do të kryhen në afatet më të shkurtra se ç'është paraparë. Njeriu me historinë nuk jeton, por nga historia mëson. Ata më të moshuarit që ende janë gjallë dhe ata që e njohin historinë e këtij qyteti, e dijnë se afar Xhamisë së Hynqarit ka ekzistuar edhe Sahatkulla, ora e qytetit që nuk ishte vetëm orë, ishte por simbol dhe informim i qytetit, arkitekturë e veçantë. Fatmirësisht erdhi dita që ta ripërtërijnë atë. Veprat e Haki Sharofit dhe Haki Stërmillit, pasqyrojnë diçka, se këmbana e ish Sahatkullës sot e kësaj dite shërben në një kishë në qytet. Ne s'jemi revanshistë, por duam që Sahatkullën tonë ta kemi pranë kësaj xhamie. Xhamia do të jetë me parametra 15 metra gjërasi dhe 20 metra e gjatë. Hyrja do të jetë me pojatën tradicionale 25 metra gjatësi dhe 12 metra gjërësi. Në të djathtë të objektit do ndërtohet minarja e lartë 37 metra, ndërsa në anën e majtë do të ndërtohet Sahatkulla, për afërsisht sa xhamia.

Kam besim te pushteti vendor, te qytetarët tanë këtu dhe në diasporë se sëbashku do të ndërtojmë një objekt model arkitekturë klasike dhe moderne, do të jetë xhami dhe monument kulture, objekt emblemantik i Dibrës për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme.

Me këtë rast kënduan pjesë nga Kur'ani, iu bë lutja Perëndisë, u ther kurban, ndërsa lopatat e para me beton i hodhën Argëtim Fida dhe Mr.ef. Ruzhdi Lata.

R. TORTE

Nga Agron TUFA

# Semiotika e dasmës shqiptare

(në variantin e Dibrës)

(Vijon nga numri i kaluar)  
Si regull, me qëllim që oda të hyjë në shtratin e ligjëritit alegorik, kërkohet njëfarë shkaku special. Ky shkak ndihmon për ta shpërngulur kuvendimin në një nivel të ri ligjërimor dhe të mos përfytyret me llomotitje për hallet e përditshme rutinore. Kësisoj, ky shkak motivon të lindë një zinxhir i tërë kompozicional fragmentesh alegorike. Ja njëri shembull.

Njëherë në një odë dasme rastisën dy dasmorë të paftuar, të cilët, përveç kësaj, kishin zënë dhe nuk i lëshonin dy prej vendeve më të respektuara në hierarkinë e odës (shqiptarët kanë një marrëdhënie të veçantë me miqtë e paftuar: atyre u kushtohet më shumë vëmendje dhe respekt, se sa të ftuarve. Por kjo nuk do të thotë që gostari i paftuar të mos përqeshet në njërin prej paravolive alegorike.) Atëherë njëri prej pleqve e filloi kuvendimin alegorik kështu: "Njëherë, or burra, në kohë të Ramazanit, një katundar grishi për darkë hoxhën. Erdhi hoxha, por kishtë mbledhë pas vetes dhe pesëmbëdhjetë burra të fshatit. Zonja e shpisë kur pa t'i drejtosheshin në derë, njëshkolonë, 16 të ftuar, u kap në siklet të madh. Ajo e pyeti të shoqin: - Burrë, mor burrë, a ke grishë sall hoxhën për darkë, apo gjithë katundin? - I përgjigjet burri: - E moj grua, moj grua, po a hala s'e ke ditë se hoxha pjell mu në muaj të Ramazan-it?"

Kjo paravoli shërbeu shkas për shtjellimin e një zinxhiri paravolish alegorike, në të cilin përqesheshin në forma të ndryshme dasmorë të paftuar. Sidoqoftë, njëri prej të paftuarve rrëfeu një çaravoli për t'u mbrojtur: "Drejtë e ke, or filan, por dëgjo çfarë ka bërë vaki në kohrat e zamanit. U nis njëherë nipi tek halla dhe sa ndenjti pak, halla i thotë: - me të thanë halla: - ulu e ha me mue, - ti ke ngranë ke shpia. Me të thanë halla: hyp në qershi e ha qershia, - për qershie asht lidhë qeni i tërbuem. Me të thanë halla: rri sonte për darkë, - e di shumë mirë se të duhet me u kthye në shpi. Prandej, s'metet gja tjetër, veç me të puthë halla në dy faqet dhe - udha e mbarë të qoftë!"

Pas kësaj paravolie ra heshjtja në odë. Të gjithë prisnin përgjigje. Por kuvendari i parë veçse tymoste, thua nuk i kishin gjegjë fjalët e kundërshtarit. Kjo heshjtje e përforconte më shumë tendosjen e duelit. Pas një copë here, ai u përgjigj: "Po, po. Na ishte njëherë një farë muratori me emrin Selim. Këtë i dhanë punë me ngrehë shtëpinë e një farë katundari tjetër me emrin Ibrahim. Mbas Selimi ia ngrehu shpinë Ibrahimit, i cili me shtat qe dy herë ma i gjatë se Selimi, ky iu avit shpisë dhe nisi me i matë muret me pashëllë, për me i pagu hakun e punës ndërtesës. Por doli se pashët e Ibrahimit qenë shumë të mëdha dhe shpia e re, e matun ksodore, doli jo shumë e madhe, e për aq punë, muratorit i takonin shumë pak pare. - Epo mirë ma bane, - i tha muratori të zotit të shpisë. - Kjo mendja e Selimit, kërkon pashin e Ibrahimit!"

Pas njëfarë pauze e mori



"Dasëm dibrane" (Fragment). Pikturë nga Zaim Elezi "Zaya"

fjalën një pjesëmarrës i tretë i odës: "Ke të drejtë, besa, - iu gjej dasmori i paftuar. - I trokiti në portë njëherë një plakë e vjetër nga Lura, një katundari prej Dibre dhe i lyp bukë me ngranë. Ajo kishtë ba udhë të gjatë dhe ishte me fuqi të këputuna. Por katundari iu gjegj asaj: - Dëgjo moj plakë, si mundesh më më lyp bukë, a nuk e di ti se në viset tona kudo ka ra zi e randë buke? - Plaka ia ktheu: - Zija mban, e shumta, një vit, po marrja e madhe të mbetet në derë sa të jetë jeta."

Kështu, para nesh kemi shembullin e kuvendimit alegorik, në të cilin palët ndahen në dy pjesë të barabarta. Është pikërisht momenti kur spektatorët të shprehin opinionin e tyre dhe, kësaj, të shpallet fitimtari i këtij dueli. Sidoqoftë, një kuvendim i tillë, do t'i kridhtë akoma më thellë pjesëmarrësit në meditim mbi natyrën etike të mikpritjes.

Zinxhirë të tillë kompozicionale alegorike kanë një interes të madh për hulumtuesit. Për një shkoqitje të shkurtër interpretative ia vlen t'i drejtohem punimit të Zhak Derridasë "E vërteta e pikturës" (IV), në të cilën kundrohet problemi i kornizës si një zonë domethënëse e cila e ndan paraqitjen (në rastin konkret - thjesht tekstin) dhe realitetin që e rrethon atë. Për Derridanë shenja rezulton njëfarë rrjedhje/ rrëkëllimi nga një shenjues tek një tjetër, ndërsa semiozisi paraqet në vetvete shtjellimin e një hapësirë mbitekstuale. Kësisoj, nëse e kundrojmë odën shqiptare nga pikëpamja e fragmentaritetit të saj, herë të përbërë prej një sasive të pakufizuar shenjash autonome (paravolitë), oda na del, përveç kësaj, dhe shenjë e pavarur origjinale, e formësuar në trajtën e një zinxhiri alegorik rrëfimesh që ndërkalen në një dialog ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të këtij rituali. Përveç kësaj, heshjtja e pjesëmarrësve që ndan pauzën nga njëra paravoli tek tjetra pikërisht në kontekstin e dialogut mund të kundrohet si një farë kornize, "frejmimi" (Derrida), dhe, njëkohësisht, element me rëndësi domethënëse që luan, jo vetëm rolin përforcues sintagmatik në odë, por që e ndryshon edhe vetë leximin e paravolive e, për më tepër, intonacionin e përgjithshëm të

bisedës ritualore, përforcon shenjësini e secilit fragment veçmas të odës, çka e shndërron odën në një rezultat gjigant konkatencioni.

### III. RRËMBIMI I NUSES

Për hulumtimin tonë paraqet interes edhe një moment tjetër i rëndësishëm në dasmën shqiptare. Në ditën e dytë të gostisë së dasmës, farefisi i zgjedhur i dhëndrit sipas linjës së gjakut dhe qumështit, nisën për të marrë nusen. Në ato zona të Dibrës veriore ku i jemi përmbajtur studimit tonë, nusen është traditë ta marrin me forcë. Ngjet kjo përfaqësimi kështu: në njëfarë distance nga dyert e shtëpisë së nuses qëndrojnë krushqit e dhëndrit, ndërsa në dyert e oborrit qëndrojnë përcjellësit e nuses. Ndërmjet dy palëve zhvillohen dialogje në këngë. Në këto dialogje korale luhet drama e rrëmbimit të nuses. Në kohën e interpretimit të këtyre këngëve, korri i burrave dhe grave nuk përzihen me palën e nuses. Kështu pra, përse nusja duhet të rrëmbet patjetër? Burimet e këtij rituali duhet t'i kërkojmë në Eposin shqiptar të Veriut. Puna është se, në akord me legjendat dhe epet e vjetra shqiptare, një ndër frikërat dhe tabutë më të forta konsideroheshin gjithëfarë llojesh të incestit. Marrëdhënia ndaj incestit të shqiptarët ishte aq e padurueshme, saqë shpesh ndalohej martesja jo vetëm me ndonjë që mund të binte lidhje e largët gjaku, por ndalohej nganjëherë martesja me vajzat e të njëjtit fshat. Në një këngë të eposit shqiptar "Dasma e Halilit", heroi refuzon të martohet me vashat e asaj krahine, duke i konsideruar të gjitha "motra". Tradita kërkonte që dhëndri dhe nusja të ishin madje prej krahinash të ndryshme, kësaj, nga kohët e vjetra nusen e rrëmbenin nga dyert e saj prindërore njerëzit e "largët". Nga një pikëpamje tjetër, një sjellje e tillë ndaj nuses është krejt e shpjegueshme në sfondin mbareuropian, përderisa na del i njëjtë me marrëdhënien ndaj etikës kalorsiake të mesjetës. Për sjelljen kalorsiake në epin Bizantin, shkruan Jurij Lotmani në librin "Kultura dhe Bum". Digenis Akritasi ("Bëmat e Digenisit"), ndryshe nga

rivalët e tij në rrëmbimin e zemrës së nuses, i ecën mbarë, pa asnjë pengesë, çka e bën atë të pikëllohet, ngase nuk kishtë bërë asnjë heroizëm, nuk kishtë lënë asnjë nam. "Të gjitha arsyet logjike të betejës janë shmangur, por nga pikëpamja e etikës kalorsiake beteja nuk ka nevojë për arsye logjike. Ajo është një bëmë individuale vetvlerësuese dhe dëshmon se heroi është i denjë për fatin e vet." (II, 78). Interesante është se krushqit e dhëndrit shfaqen para shtëpisë së nuses, duke mbajtur ngritur flamurin nacional. Për vendet e Ballkanit ky është një rast mjaft i rrallë - përdorimi i simbolikës nacionale në kohën e ritualit të dasmës. Në përgjithësi, shqiptarët e ngrenë flamurin vetëm në tre raste: 1) në kohën e pikut të betejës luftarake; 2) në kohën e ndërtimit të ndonjë ngrehine, shtëpie të re; 3) në kohën e ceremonisë së dasmës, në variantin verilindor të saj. Nisur nga kjo mund të supozojmë se flamuri është simbol i ngadhënjimit, zotërimit (të teritoreve, gjakut, femrës), dhe në rastin e shqiptarëve interpretant i shfaqjes së flamurit është pikërisht beteja e kurorëzuar me fitore. Përveç kësaj, një model mental mjaft i përhapur në rastin tonë mund të jetë ideja - pikërisht e posedimit suksesiv, çka është po aq e lexueshme edhe për jo-shqiptarët.

### IV. MACJA

Moment i mbramë me rëndësi në dasmën tradicionale shqiptare është veçimi i çiftit, ose i njohur ndryshe, "mbyllja e dhëndrit" në dhomën e dhëndërisë, të përlloritur kasten për të sapomartruarit. Që nga koha e hyrjes së dhëndrit në dhomë, nusja gjithë ditën e kaluar ka nusëruar nën vello dhe vetëm në mesnatë atë e shpjenë në shtratin martesor në pritje të shfaqjes së dhëndrit, të cilin - në të shumtën e rasteve - ajo nuk ka mundur ta pikasë, jo vetëm përgjatë dasmës, por edhe para saj. Nga pikëpamja psikologjike, çatis momenti më i tendosur e më dramatik për gjithë ceremoninë e dasmës. Nusja mbetet vetme

në dhomë, dhe vetëm një maceje i lejohet të jetë e pranishme në minutat e shumëpritura të njohjes me burrin. Në dhomë hyn burri dhe ulet heshtur në shtratin martesor. Ai rëndom dredh një cigare, ndërsa nusja duhet të ketë një shkrepse dhe t'ia ndezë. Ky është një shkak i sajuar, gjest që i jep shtysë kuvendimit të tyre, pas të cilit ata gatiten të shtrihen. Kur nusja tashmë është shtrirë, dhëndri, para se me u shtri me nusen, mer macen dhe me dorë të fortë e vendosmërisht e ther atë në sy të nuses. Mandej ai lan duart dhe shtrihet në shtratin martesor, afër nuses së tij.

E gjitha kjo kalon në heshjtje, si një teatër hijesh, dhe prandaj këtë shenjë mund ta shpiem në radhën e shenjave jo verbale që shoqërojnë ceremoninë e dasmës. Për shqiptarin macja - është jo vetëm bartës simbolik i "femërores", por edhe kafshë e cila çon një jetë "shëtitëse" çati më çati, e dac më dac. Duke vrarë macen para se të shtrihet në shtratin martesor, dhëndri kësodore i jep, me demek, të kuptojë nuses, se që nga ky moment ajo i përket tërësisht atij dhe, po guxoi "t'ia dredhë" apo t'i japë vetes më shumë liri (në kuptimin seksual), atëherë dora e tij nuk do të dridhet dhe ai, do të veprojë vendosmërisht, ashtu siç veproi me macen.

Përveç kësaj, mendojmë se macja ka marrëdhënie të drejt-përdrejtë me flitë arkaike martesore dhe metanimikisht i ka rrënjët në përfytyrimin e dasmës jo vetëm si pushtim (lufta në mënyrë të natyrshme asociacion me flinë, vrasjen dhe nënshtrimin e dhunshëm), por edhe me gjakderdhjen. Në rastin konkret duke derdhur gjakun e maces, dhëndri metanimikisht i paraprin kuptimit mitologjik të martesës si lidhje e tokës me qiellin dhe, natyrisht, vetë humbjes së virgjërisë së nuses.

Kështu, nata e martesës përmbyll ceremoninë tradicionale të dasmës, e cila përbëhej, sikundër e kemi kuptuar, prej një radhe njësisht të pavaruara shenjore, të lidhura me rrugë konkatencionale në një sistem që reflekton mentalitetin e shqiptarëve dhe, nga ana e përkundërt, korrekton përfytyrimet tradicionale të shqiptarëve mbi të moralshmen dhe të shenjtën përgjatë shumë shekujsh.

### Bibliografia

- I. Kerllot H. E. Fjalori i simboleve. - I.: "REFL-book", 1994.
- II. Lotman Jurij. Kultura dhe Bumi. -Botim i "Gnozis"; Frupi botues "Progres" 1992.
- III. Pierce C.S. Logic as Semiotic. The theory of signs. Në përmbledhjen: Semiotics: An Anthology. Bloomington, 1983.
- IV. Derrida J. The Truth in Painting. McLeod. Chicago, 1987. P. 83-118.
- V. Xhaferr Martini. "Perlat e Dibrës", Tiranë, 1999.

Prof. Dr. Agron XHAGOLLI

## FOLKLORI NË LURË\*

Lura paraqitet një krahinë etnofolklorike e veçantë dhe me interes në planin etnologjik dhe folklorik. E shtrirë në pjesën veriperëndimore të rrethit të Dibrës, kjo krahinë përfshin fshatrat: Fushë-Lurë, Pregj-Lurë, Kraj-Lurë, Borje-Lurë, Gjur-Lurë dhe Armollë. Pavarësisht nga lidhjet, marrëdhëniet me krahina të tjera të afërta, si të Dibrës, Matit, Mirditës, Lura ruan në thelb një mëvetësi relative në krijimtarinë folklorike. Ky pohim mbështetet edhe në analizën e përgjithshme të krijimtarisë popullore gojore të mbledhur në Lurë. Përgjithësisht në këtë krijimtari kemi të bëjmë me një simbiozë të natyrës, përfaqësuar nga mjedisi pitoresk, me pyjet tërheqës, me liqejt aq të përmendur, me lëndinat gjelbëruese, dhe krijimtarisë folklorike, që shpreh shpirtin poetik, elegancën e brishtësinë, monumentalitetin dhe bukurinë, jonet e ëmbla dhe melodioze, lëvizjet elegante, estetizmin të arrira e funksionale. Folklori në Lurë, nga regjistrimet e kryera në kohë të ndryshme, përgjithësisht, rezultojnë të jetë i pasur në gjini, lloje e zhanre të ndryshme. Por në të mungojnë apo nuk janë praktikuar edhe lloje a zhanre të njohura në krahina të tjera. Kujtesa kolektive ka përcjellë deri në ditët tona një pjesë të asaj krijimtarie gojore të realizuar dhe të transmetuar në shekuj. Ato që kanë arritur deri më sot, si një pjesë e trashëgimisë gojore popullore të Lurës, krijojnë mundësinë e dhënies së një tabloje të jetës së folklorit në Lurë.

Realisht duhet pranuar se kërkimet folklorike në këtë krahinë etnofolklorike janë relativisht të vona. Janë për t'u veçuar ekspeditat e kryera nga punonjës shkencorë të institucioneve shkencore si në vitin 1953, 1959, 1977 etj.<sup>1</sup>, por edhe nga mbledhës të përkushtuar që kanë punuar në Lurë, si Hilmi Kolgjegja<sup>2</sup>. Arritjet e deritanishme kërkimore, të depozituara në arkiva apo të sjella nga botimet, më të shumta në tekstet e këngëve, të lejojnë të trajtohen pasuritë folklorike të Lurës, se si paraqitet kjo krahinë edhe përsa i përket kujtesës dhe trashëgimisë kolektive.

Folklori në Lurë e ka bërë jetën e vet si art sinkretik në forma të tilla, si: proza e poezia popullore, folklori muzikor dhe ai koreografik. Krijimet e ndryshme praktikohen si me shoqërim, ashtu dhe pa shoqërim instrumentor. Instrumentet më përfaqësues në Lurë janë fyelli, kavalli, lauria, pipzat, çiftelia, curlja, lodra etj.

Si tipare karakteristike të formave kryesore të jetës së folklorit në Lurë mund të veçojmë: a) Për poezinë popullore nënvizojmë gjallërinë, kuptohet, në intensitet të ndryshme, të disa llojeve të lirikës. Përmendim këtu *këngë pune, rituale, këngë djepi, dashurie, vajtime* dhe veçanërisht *këngët e ceremonialit të dasmës*. Nga baladat shqiptare në përgjithësi në Lurë janë të pranishme vetëm disa motive të kufizuara. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për këngët historike. Kjo situatë e teksteve përbërës në krijimet folklorike e përcakton Lurën më së tepërmi si një krahinë me krijimtari të natyrës lirike.

Për folklorin muzikor theksojmë praktikimin e krijimeve të pasura për nga pikpamja melodike, e repertoreve me ritme të ndryshme, ku mbizotërojnë ritmet 7/8 dhe 2/4, veçanërisht në këngët e dasmës. Nga pikpamja muzikore interes paraqesin krijimet rituale, që sjellin elemente të kulturës së hershme muzikore, si dhe vajtimet e grave, me strukturë interesante. Me mjaft domethënie janë dhe emërtimet popullore në Lurë për ato që vajtojnë. Për zërin e parë thuhet *ajo që ia ze*, për ato që e pasojnë, *ndihmëset*, si dhe grupi i grave që *ia pret*<sup>3</sup>.

Për folklorin koreografik duhet thënë se bazën e sistemit të kërcimeve të burrave e përbëjnë *"vallet dyshe"*. Praktikohen edhe *"vallet"*. Me këtë emërtim njihen ato që luhen në grup, të shoqëruara me këngë. Edhe në Lurë specifikohe me termin *"hora"*. Forma më e hershme e valleve të grave në Lurë është *"hora"*, që luhet në dy forma: *në rreth të mbyllur dhe në dy grupe, në formacion gjysmër-*

*rethi*. Nga gratë në Lurë praktikohen edhe *"kçimet"*. Ato luhen nga dy valltare dhe shoqërohen me instrumenta.

Duhet theksuar se horat në rreth të mbyllur praktikohen në Lurë edhe në formë të përzier, burra dhe gra, dhe në këto raste zakonisht, përveç shoqërimit me këngë, përdoret edhe lodra<sup>4</sup>.

Si një krahinë malore, e izoluar, për shkak të pozicionit gjeografik, Lura paraqitet, përsa i takon artit folklorik, si një konservuese e traditave gojore, duke ruajtur, në një masë të vlerësueshme, autenticitetin, mirëfilltësinë folklorike. Atje, siç e cekëm më lart, bashkëjetojnë lloje të ndryshme folklorike, me zanafillë në kohë e me shtrirje vertikale, nga periudhat më të hershme, deri në ditët tona. Këtu e kanë shpjegimin e bashkëekzistencës së tyre, me intensitet të caktuara, lloje e praktika tepër të hershme, si p.sh., ritualet, deri te këngët e krijuara e të përfshira në qarkullim folklorik gjatë bashkëkohësisë sonë. Ndofta, edhe dukuria karakteristike për këtë krahinë, që edhe sot krijimtaria folklorike ruhet e praktikohet, si i vetmi lloj arti, i mundshëm për t'u praktikuar dhe për të plotësuar më së miri nevojat artistike shpirtërore të Lurës, ka ndikuar dhe ndikon në këtë bashkëjetesë.

Krijimtaria folklorike në Lurë e ka përvijuar shtratin e vet, si dhe është zhvilluar apo është pasuruar më tej, duke na dhënë sot një tablo të përgjithshme me burime të tilla: 1. Krijimtaria folklorike që ka një shtrat ndërkrainor a mbarë shqiptar; 2. Krijimtaria folklorike vendase e ardhur nga e kaluara; 3. Krijimtaria folklorike e huazuar nga banorët e Lurës në vite; 4. Krijimtaria e më vonë folklorike, e përfutur në bashkëjetesën me krijimtarinë e kultivuar dhe amatore.

Duhet pohuar që në fillim se në tërësinë e folklorit në Lurë vendin parësor e zënë krijimet folklorike të përcaktuara si vendase. Krijimet e këtij grupimi janë të llojeve folklorike nga më të ndryshmet. Ato janë me mjaft interes edhe në nivel kombëtar, kur është fjala për pasurimin dhe raportet shprehëse të unitetit folklorik kombëtar. Nëpërmjet originalitetit, veçorive specifike, krijimet folklorike, t'i quajmë përgjithësisht autoktone, përcjellin një traditë të pashkëputur nga folklori shqiptar, por edhe e pasurojnë atë në tematikë, dhe në format e shprehjes, në vlerat artistike. Megjithatë, duhet pohuar se përgjithësisht përcaktimi i prerë i kufijve të burimeve të folklorit në Lurë është i vështirë të realizohet plotësisht. Njëkohësisht, theksojmë se është me mjaft interes shkencor nxjerrja në pah e vlerave folklorike, pavarësisht nga niveli që ato përfaqësojnë. Kjo ngaqë, në fund të fundit, realiteti folklorik është në përbashkësinë e të gjitha vlerave nga burimet e përthithura në qarkullimet folklorike.

Ka mjaft krijime folklorike edhe në Lurë që janë me një shtrirje më të gjerë se në një krahinë, pa mundur të jepet diçka e prerë rreth përkatësisë nistore. Të tilla janë një pjesë e fondit të baladave, përrallave, legjendave mitologjike, këngë të punës e rituale etj. Veçse këtu duhet theksuar një moment me rëndësi, jo vetëm për krijimtarinë folklorike në Lurë. Krijimet e një shtrirjeje më të gjerë përcjellin momente të veçanta, një plan edhe në trajtim lokal, një ripërpunim gjatë huazimit apo praktikimit. Le ta ilustrojmë me baladat mitologjike. Jeta e këtij zhanri folklorik në Lurë, siç na e përcjellin kërkimet e kryera deri tani, është jo aq e gjerë. Njihjen të praktikuar balada si ajo e mbajtjes së fjalës së dhënë, e rinjohjes burrë-grua, vëlla-motër etj. Por edhe brendapërbrenda këtyre baladave, në një shtrirje të tillë të kufizuar të motiveve, në Lurë vihen re trajtesa jo tipike, karakteristike apo zotëruese në motivet themelore, të një plani më të përgjithshëm.

Vetëm ndryshimet e emrave të personazheve në balada të kësaj natyre, ndonëse jo dukuri tipike dhe të qenësishme, tregojnë se krijime të tilla janë përthithur, nëse vërtet ka ndodhur kësh-

tu, në një kohë të caktuar, u janë nënshtruar kërkesave të atij mjedisi që i ka bërë pronë të vetën. Pavarësisht nga prania e dy besimeve fetare në banorët e Lurës, edhe brendapërbrenda së njëjtës familje, emrat e personazheve në baladat e mbledhura janë të myslimanizuar. Kështu, përveç varianteve të njohura të baladës së Ymer Agës, në Lurë janë regjistruar edhe variante me personazhe Hisenin dhe Gjuheren. Gjithsesi, ato sjellin, krahas përcaktimit më të plotë të shtrirjes teritoriale, edhe elemente që e pasurojnë vështrimin rreth baladave shqiptare në përgjithësi.

Prania në Lurë e mjaft praktikave të lashta, të cilat dihet se janë të shoqëruara edhe me krijime folklorike, flet se mungesa e regjistrimit të këtyre të fundit është thjesht dëshmi e mospraktikimit në periudhat kur janë bërë kërkimet. *Buzmi, Dita e Verës, darka e deshe, dreka e dheneve, gjoshtaret* etj. janë disa nga festat popullore në të cilat janë ruajtur, edhe në Lurë, doke e zakone të lashta pagane. Gjurmët e gjetura nga praktikantët e festimit të Buzmit<sup>5</sup> të bindin se atje ka pasur krijime folklorike të një natyre të lashtë, por që me kohë janë nxjerrë nga qarkullimi.

Pohimi i mësipërm shihet edhe më mirë të këngët e punës dhe ritualet e mbledhura në Lurë. Kjo, si një krahinë kryesisht blegtorale, ka praktikuar një sërë krijimesh që lidhen me procese e praktika rituale në fushën e blegtorisë. Për ilustrim përmendim këngët të ndryshme, si ato që lidhen me mjeljen e bagëtime, me tundjen e bulmetit etj. Është e njohur pothuajse në të gjitha viset shqiptare praktika rituale që lidhet me tundjen e bulmetit për herë të parë. Kjo praktikë në Lurë paraqitet në një formë interesante, që flet për periudha ngjizjeje tepër të hershme, si dhe për ruajtjen e tyre në një gjendje të lashtë deri vonë. Si e tillë paraqitet me interes të veçantë në tërësinë e ritualit përkatës midis shqiptarëve. Duke tundur bulmetin, thuhet: *"Tunu, mtej, vrrëjk e vrrëjk, Qite tlyenin me shenejk; / Tunu, mtej, rena - rena; / Se kam lan' gjan' mrena"*<sup>6</sup>. Nëse nuk dilte gjalpi, shkohej në pyll *"për të vjedhur qyqen"*. Shkohej të druri ku rrinte qyqja, merrej një degë prej tij, që quhej *"vjedhja e shejit"* dhe kjo i varej tundësit<sup>7</sup>. Sipas besimit më të përgjithshëm, në këtë mënyrë do të ishte më e lehtë tundja e bulmetit.

Krijimtaria folklorike tradicionale e pëcaktuar si vendëse, është më e pasura. Në tërësinë e saj përfshihen krijime të llojeve më të ndryshme dhe më të gjera. Është në këto krijime psikologjia e lurasit, mjedisi i Lurës, peisazhi malor blegtoral, fauna dhe flora e Lurës, toponomastika që lidhet me Lurën etj.; të gjitha këto indikacione të rëndësishme që, në mos përcjellin plotësisht origjinën, sjellin një qarkullim shumë të gjatë kohor. Realizimi i gjeografizimit të krijimit folklorik flet për një lokalizim kohor e vendor të vetërealizuar apo të përpunuar që herët.

Të këtij përfaqësimi përmendim një shumicë krijimesh nga këngët e djepit, të dashurisë, këngësh historike, dhe, sidomos, vajesh, legjendash historike dhe këngësh dasme. Do të ndalemi këtu vetëm në tre llojet e fundit. Do të thoshim se vajet e Lurës përfaqësojnë një thesar të vërtetë të vajtimeve shqiptar. Ato bëjnë pjesë në fondin më të realizuar, duke përcjellë një pasuri të llojllojshme të figurave artistike të shumta, si: epitete, krahasimi, personifikimi, similituda etj. Vajet janë produkt i improvizimit mbi një shtrat përgjithësisht të qëndrueshëm. Pavarësisht nga një afëri më e dukshme me vajet në Mirditë, do të thoshim se vajet në Lurë janë, për mendimin tonë, më të goditura artistikisht, krijojnë situata shumë prekëse, janë të një plani më intim. S'ka se si të mos tërheqim vëmendjen vargje të tilla: *"Ti m'u pajke si molla në gem; / Ti m'u pajke si zogu n'flurem; / A shkull' lisi me gjith' rrema; / I ka votun toks mrena; / Jan' fushat tu lulzue; / Vin'*

*malet tu murgjullue; / Vjen qiqa tu kënuë; / Nana t'rrren tu lotue"*<sup>8</sup>.

Do të thoshim se të një interesi të veçantë paraqiten nga Lura legjendat historike; posaçërisht ato që lidhen me emrin, veprën dhe periudhën e Skënderbeut, si dhe legjendat toponimike, veçanërisht ato për liqejt e Lurës. Krijimtaria folklorike e këtij zhanri, toponomastika, gojëdhëna të ndryshme që lidhen me Skënderbeun dhe epokën e tij, të mbledhura deri më sot në Lurë, e bëjnë këtë krahinë të spikatur edhe në nivel kombëtar. Janë një varg legjendash për figurën e Skënderbeut, për kala të tij, për objekte të ndryshme, toponime të lidhura e të shpjeguara me emrin e Skënderbeut.

Në grupimin e tretë të krijimtarisë folklorike në Lurë do të përfshinim ato që duket se janë përfutur përmes huazimeve prej krahinave të tjera. Këtu mund të përmendim këngë historike, ndonjë këngë dashurie etj. Gjithsesi, numerikisht tërësia e tyre nuk përbën shqetësim për vullën autoktone të krijimtarisë folklorike në Lurë.

Përsa i përket grupimit të katërt, krijimet e vona folklorike, të përfutura në ecurinë e traditës, por edhe nën përvojën e artit të kultivuar dhe amator, duhet pranuar se numri i tyre është relativisht i kufizuar. Dihet se për shkaqe të caktuara janë paraqitur si folklor edhe krijime të cilat nuk u janë nënshtruar dhe nuk kanë respektuar ligjëtoritë folklorike. Por, gjithsesi, ky fakt nuk mund të bëhet shkas për të mos pranuar se folklori edhe në Lurë është pasuruar me tema të reja, me krijime që i janë bashkëngjitur me dinjitet krijimtarisë folklorike tradicionale. Nuk mund të mos përmendim këtu këngët të tilla, si *"Shtat' liqejt' e Lurës"*, që kanë pasur një qarkullim më të gjerë se kufijtë krahinorë. Edhe pse me autor të njohur, krijime të kësaj natyre, që ruajnë shtratin tradicional, realizojnë qarkullimin folklorik, përfshihen në fondin e folklorit të Lurës.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, në trajtesën tonë do të ndalemi te roli dhe ndihmesa që kanë sjellë në jetën e folklorit në Lurë bartësit e talentuar. Ata kanë qenë dhe janë të moshave e të gjinive të ndryshme. Shfletohen materialet e mbledhura gjatë ekspeditave të ndryshme dhe një vend të nderuar kanë bartësit tipikë që kanë bërë të mundur gjallesën e krijimeve folklorike nga më të ndryshmet. Sheh dorëshkrimin e vitit 1959 dhe të fiksohen emrat: *Ramadan Doçi, Gjillkë Loka, Bardhe Gjeçja* etj., që sot mund të mos jetojnë më, por ndihmesa e tyre ka bërë të mundur që të fiksohet një pjesë e mirë e visarit folklorik të Lurës. Nderimi dhe mirënjohja më e thellë për ta, por edhe për interpretues dhe ekzekutues të tillë të njohur, si këngëtarët *Arif Buci, Ibrahim Haldeda, Ali Peka, Trëndelina Buci* e deri te këngëtarë i mirënjohur *Arif Vladi*, me fillësë në folklor, etj.; valltarët *Sul Peka, Aqif Ajazi, Margjela Vladi, Xhemil Duka* etj.

Po kështu, është e nevojshme të nxirret në pah puna krijuese e rapsodëve, të cilët kujtesa kolektive i ka lënë jashtë vëmendjes. E njëjta gjë do të vlenë edhe për krijues të tillë si *Hilmi Kolgjegja, Ali Peka* etj., një pjesë e krijimeve të të cilëve, pra si fillësë krijuese individuale, janë përfshirë në qarkullimin folklorik në Lurë. Një punë e tillë do ta bënte plotësisht të qartë vendin që ze folklori në Lurë.

\* Përgatitur dhe mbajtur në formë të shkurtuar: Konferenca shkencore "Vlerat etno - turistike të zonës së Lurës", Tiranë, 1995.

<sup>1</sup> Regjistrimet e kryera në këto ekspedita janë të sistemuara në Arkivin e Folklorit të Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë (më tej AFIKP).

<sup>2</sup> Përveç materialeve të arkivuara në AFIKP, H. Kolgjegja ka botuar edhe një vëllim të veçantë folklorik, "Këngë popullore nga rrethi i Dibrës", ku janë përfshirë dhe një numër krijimesh folklorike nga Lura.1. Shih më gjerë H. Filja, Relacion rreth rezultateve të ekspeditës në rrethin e Dibrës (6 - 27 qershor 1977), AFIKP, f. 15.

<sup>4</sup> Edhe për fushën e folklorit koreografik shih më gjerësisht R. Bogdani, Relacion i cituar, f. 28 - 29.

<sup>5</sup> AFIKP, Q. Haxhihasani, 1968, f. 62 - 63.

<sup>6</sup> Lirika popullore, vëllimi I, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1988, f. 544.

<sup>7</sup> Shih A. Xhagolli, Relacion i cituar, f. 33.

<sup>8</sup> AFIKP, A. Xhagolli, dosja e ekspeditës në rrethin e Dibrës.

# Kartolina urimi nga Naim Plaku

## Fjalë pa tufa

Këto letra me urime  
Po ua ndaj me shumë dëshirë,  
janë ca bejte,  
janë ca shkrime,  
janë për ju dibranë të mirë.  
Janë pak fjalë  
pa notka e tufa <sup>1)</sup>  
që i mblodha radhë-radhë,  
mos kujtoni se u struka  
duke prit Ujkun e Bardhë. <sup>2)</sup>  
Do flas hapur,  
jo me shifra  
Siç e ka zakon shpesh Dibra,  
se një sharrë na ka prerë,  
nga një degë kemi zbritur,  
në një sofër,  
në një odë  
jemi shtrosur e jemi rritur.  
...Se kush hyn në Odë të Dibrës  
e kush ulet në konak  
merr me vehte një kandar,  
një metrosh  
e një biçak <sup>3)</sup>  
...Se kush shtrin dorën e bardhë  
në tri Teqet e mbi jetima <sup>4)</sup>  
Zoti i Madh ia bën mbarë,  
për mejdan del trim mbi trima.  
Bujrum, pra, tek "Rruga e Arbërit",  
shtrini duart,  
ngulni këmbët,  
do të shkojmë te ajo Dibër  
bash atje  
ku kemi rrënjët!

1-Pa njolla e zbukurime, të vërteta.

2-Duke pritur atë që nuk arrihet kurrë, të pamundurën. Është e pamundur të gjendet në pyll ujku i bardhë. Këtë vjen edhe shprehja: prit e prit sa të dalë ujku i bardhë.

3-Thuhet se që të meritosh të ulesh në Odën e Dibrës, në kuvend, duhet të kesh një kandar për t'i peshuar fjalët, një metër për të matur veten dhe të tjerët dhe një biçak (thikë me dy presa) për ta provuar se së pari tek vetvetja atë që thuhet.

4-Art, kulturë, sport.



**Musa Rriçkut**

Pa dëgjo, more lum miku,  
Te kjo rrugë ndalo tash,  
Ka bizneset Musa Rriçku  
Në Larakë, në "Gintash".

Jepja dorën dhe uroje  
Me gjithë zemër këtë burrë,  
as prej dore,  
as prej goje  
një të keqe s'ia pamë kurrë...

Eh, ti ec djalë i Limjanit,  
ngjitu lart te degë e lisit  
mirësia,  
bujaria  
fort ia rritën emrin fisit.

Për çdo vit i shton bizneset  
djersa e munda mos të shkoftë kot,  
siç të do e bardha zemër:  
-T'u baftë "Keni" njëqind mot!



**Nuri Abdiut**

Shkodra të njohu dhe të nderoi  
Vite me radhë,  
një jetë të tërë, o Profesor,  
dhe prapë ai zëri yt i ëmbël  
kumbon në auditor.

Eh, sa mësues në qindra shkolla  
shpërndarë nëpër atdhe.  
-Përse,  
pse jeni kaq të mirë, vallë?-  
u themi ne.

Dhe vënë buzën në gaz,  
e çelin fytyrnë si ylberi pas shiut,  
e të thonë me krenari:  
-Jemi nxënësit e Profesor Nuriut?  
O Profesor i nderuar,  
na sill edhe një tjetër çast gëzimi,  
një vepër tjetër  
si "Hoxhë Tasimi"!



**Sadri Abazit**

Eh, more i dashur mik,  
ç'të uroj për këtë vit?  
Hidhi sytë nga Ujmuja  
Që të shkojë mbarë "Usluga"  
Ti po ec  
dhe po ec mirë...  
Le të flasin gojë e liga  
le të mbushen,  
le të fryhen,  
se gjithkush ka rritur namin,  
kur mban syrin tek vendlindja.  
Eh, more Sadri Abazi,  
seç më dole prapë në shteg,  
si dikur  
një djalë çapken  
tash më i miri biznesmen.  
Nuk e di kjo "Rrugë e Arbërit"  
a të sjellë diçka ndërmend,  
se kjo Dibra ka dy rrugë  
që të çojnë në Parlament...  
Djersa e ballit,  
dora e bardhë  
njëmijë pash e ngrejnë burrninë,  
se dibranët mirë e dinë,  
kush asht rrit si lis majë kreshtës  
asht provuar tek Rrasë e Vleshës<sup>1)</sup>  
Ndaj kjo dymijë e tetë  
le të bëhet,  
le të jetë,  
hem për ty, vëllezër e motra,  
lumturi, gëzim, shëndet!

1-Asht pruar te Rrasa e Vleshës- është një shprehje për të treguar diçka të saktë, të provuar. Perëndimi i diellit në Rrasën e Vleshës tregonte saktësisht orën 12 allaturka, prandaj për të provuar orët e për t'i rregulluar ata shkonin e shikonin perëndimin e diellit te Rrasa e Vleshës, siç kishte ba sheh Ibrahim, themeluesi i Teqes së famshme të Vleshës.



**Rakip Sulit**

Sa mirë na vjen,  
(e themi me gjithë zemër)  
kur emrin e bardhë "Aurora Group"  
e shohim në çdo qytet,  
në çdo qendër.

Dibra ka nevojë për emra të mirë,  
të nderuar,  
për artistë të shquar,  
për sportistë, shkencëtarë,  
mjeshtër,  
ndërtues të talentuar,  
mjekë,  
mësues  
e bujq të rrallë.  
Kështu dalngadalë do të rritet muri  
duke vënë sikush në këtë ngrehinë  
nga një gur,  
siç bën i nderuari Rakip Suli!  
Ashtu siç nuk shterr kurrë ujët e Drinit  
përmes Çidhnës ditë e natë,  
ashtu i ectë edhe Rakipit  
e në biznes i shkoftë mbarë!  
Siç është bora në malet tona  
krejt e pastër,  
krejt e bardhë,  
ashtu qoftë edhe "Aurora"  
duke u ngjitur gjithmonë lart!



**Shaban Bitrit**

Inxhinier i nderuar,  
ja që na erdhi rasti për të përshëndetur,  
për të të uruar:  
-Të pafshim përherë të qeshur,  
përherë të gëzuar!  
Qofsh tërë energji,  
përherë në lëvizje,  
në vrapim  
si dikur në Pukë,  
kur ishe i ri!  
Në thinjat e bardha si lule bore  
ndrit djersa,  
mendja jote,  
në rrugë, ura, diga  
nga Shkodra, Miloti e Fierza.  
Hej, sa mirë na vjen,  
kur dëgjojmë e ndjejmë,  
këtë rrugë e ndërtoi,  
këtë pallat,  
këtë shkollë e ngriti  
inxhinieri ynë i nderuar  
Shaban Bitri.  
Dhe ja, përsëri,  
fati po na ndihmon,  
që dhe një pjesë e "Rrugës së Arbërit"  
të ketë firmën  
"Almo Konstruksion"

**Zaim Korsit**


Ty të lumtë, Zaim Dibrani,  
të shkoftë mbarë,  
hej, burrë i dheut,  
përmes syve tuaj të shkruar  
ndritën shpatë e Skëndërbeut!  
Në shumë vepra ke lënë emër,  
t'u mbushtë dora,  
t'u shtoftë sofa,  
se çdo gjë ti e ke ndarë  
me vëllezër  
e me motra!  
Ti i nden litarët larg, <sup>1)</sup>  
larg,  
shumë larg tek iliriani,  
ku çdo gjurmë është larë me gjak  
që nga Çidhna  
e Grazhdani.  
Diamant të ka bërë Zoti,  
"Diamant" t'i qofsh për jetë,  
se me ty, o Zaim Korsi  
Dibra bëhet me dy fletë.

1-I nden litarët larg, i analizon punët thellë, shikon larg, në thellësi të kohërave e ngjarjeve.

**Faik Bruçit**

"Kur të lodhesh rrugës së gjatë,  
shkulma djerse t'i shkojnë trupit,  
ka pas thënë Dibra këtë fjalë:  
-Shko e praj tek baçja e Bruçit! <sup>1)</sup>  
Ti, Faik,  
këtë bahçe e prure  
krejt të pastër e plot lule.  
Të urojmë, të vijë një ditë  
gjithë Tirana t'i kthejë sytë  
t'i besojë veç dorës tënde  
të pastrojë mbetjet urbane...  
Ku s'është ndjerë dora jote?  
Ndër dekada  
e ndër vite,  
në ndërtime,  
në montime  
duke çarë në shtigje drite.  
Kompania veç po rritet,  
Po zgjerohet e po shtrihet,  
Anëmbanë  
metropolin me pallate  
Mbushi  
e fuqishmja,  
e besueshmja Firma "Bruçi".

1-Për të shkruar nga Dibra e poshtme dhe Luma në Tiranë rruga e vjetër këmbësore kalonte nga Katër Grykët dhe ishte bërë zakon që të pushonin udhëtarët tek një bahçe në sinorët e fisit Bruçi, të cilët i pritnin dhe i përcillnin me një bujari të veçantë tek kjo lëndinë e bukur, i gostitnin me ç'tu ndodhej. Këtej ka mbetur dhe shprehja "shko e praj tek Baçja e Bruçit, si një sinonim i një vendi të rehatshëm, të bukur e të qetë, që ta heq lodhjen.

**Shaban  
Sinanit**

I dashur Shaban,  
sa keq më vjen, mor aman,  
ia more  
a ia vodhe Reçit tënd të dashur  
tërë bukuritë  
e madhështinë që ka!  
Kreshatve u more ashpërsinë,  
Mallës qartësinë,  
bjeshkëve hijeshinë.  
Gërmime në themelet e kullave të gjata  
dhe mbushe hejbet me flori,  
pleqve u zhvate mençurinë,  
nënëve dashurinë,  
cucave dhe nuseve u grabite këngët,  
vallet,  
horet,  
të parëve varret,  
More e ç'nuk more  
dhe m'i fute e po mbush Veprën tënde  
për të ngritur një përmendore-  
mbi themelet e legjendave.  
Por me Kadarenë çpate?  
përse ma mbylle në dosjen K.  
me kapak floriri,  
Ah, paske qenë kopil kopili,  
paske qenë diçka më tepër se ç'të dija  
duke u bërë i pavdekshëm  
me Kritika.  
Hajt, të shkoftë mbarë,  
por kam një këshillë:  
-Dil njëherë vitin tjetër nga Reçi  
se malli e ka marrë!

**Fatmir Kurtit**

I dashur Fatmir,  
unë nuk të njoh,  
por kam dëgjuar fjalë të mira për ty,  
ke hapur biznese të ndershme,  
të mbara  
duke e nisur çdo gjë  
nga e mira,  
nga e para.  
Të them të drejtën paske pasur dhe fat,  
se kjo "Rruga e Arbërit"  
do të nisë pikërisht aty  
ku ke bërë konak.  
Ti e di mirë se dibran je,  
puntor,  
i mençur e bujar,  
ke hedhur shta aty mes bjeshkëve,  
ku bijtë e bijat e mira  
zanat e malit  
dhe nënat u thonë:  
-Të fryftë hizri në gojë! <sup>1)</sup>  
Pse, a s'është dhe për ty  
më e mira uratë kjo  
për këtë Vit të Ri

1-Sipas besimit mysliman atij që i del përpas hizri e aq më mirë kur i fryn në gojë, ka mbarësi të përjetshme e të jashëzakonshme në çdo drejtim.

**Demir Rusit**

"Alla-jura, alla-jura,  
ne kjo Dibra paska burra"...  
Kështu ka thënë një këngë e moçme,  
kur trimëria,  
bujaria,  
bënin dritë në flakë baruti,  
tash po them se kjo burri  
ka mbetë gjallë tek Demir Rusi...  
Se e reja  
me të vjetrën  
janë lidhë në mijra tela,  
ndaj dhe emri,  
nderi e besa  
vijne e rriten nëpër breza.  
Ç'të të them moj shpia e Rusit,  
ke shkrep xixa në Homesh.  
-Mos t'u vgjerrtë nami kurrë!-<sup>1)</sup>  
Ky urim të vjen prej nesh.

1-Mos t'u vgjerrtë nami-Mos të humbasin vlerat që ke krijuar ndër vite.

**Ramazan  
Bibës**

Të shohim tek ec,  
tek vrapon,  
plot gjallëri,  
përherë i fuqishëm,  
i papërtuar,  
përherë i ri.  
E ku s'të kemi njohur,  
e ku s'të kemi parë ndër vite,  
dekada,  
Në fusha, në male,  
duke lartësuar diga, pallate.  
Në Fierzë, Koman, në Dibër,  
Në Tiranë ke lënë emrin tënd të nderuar  
ndaj shpesh kemi ndjerë  
kemi dëgjuar:  
-Këtë e kemi prej Ramazanit,  
qoftë i bekuar!  
Këtë të urojmë dhe ne, i dashur mik,  
për 2008:  
-Paç mbarësi,  
e t'u bëftë pasuria det!

(Vijon në faqen 8)

*Kartolina urimi  
nga Naim Plaku*

(Vijon nga faqja 7)



**Bujar  
Methasanit**

Si një mjek i mirë dentist  
dhe si mik i "Rrugës së Arbërit"  
po vijmë drejt klinikës tënde  
në kompleksin e "Gintashit"  
Nuk vijmë veç ne dibranët aty,  
por të gjithë,  
ai që të njeh  
e të di.  
Vjen ai që ka provuar dorën tënde,  
fjalën e mirë e të ngrohtë,  
pritjen,  
përcjelljen,  
mjeshtrin e talentuar dentar.  
Ndaj klinika jote është kaq e gjërë,  
plot dritë e bukuri,  
se bukurinë e sjell  
ai që ka emrin e vërtetë Njeri.  
Gëzuar, pra,  
ja dhëmbët nuk na dhëmbin fare,  
se i ndreq dhe i shëron  
dashuria juaj e madhe...




**Bujar  
Karoshit**

Shumë fjalë të mençura thuhën  
andej nga ana jote,  
andej ku Drini  
qesh e qan,  
ndaj nuk i dihet kësaj bote  
të shkel me këmbë  
a në krah të mban.  
Thonë, kali i bardhë lahet vetë,  
ndaj s'ke nevojë për fjalën time,  
por s'mund të rri aspak i qetë,  
pa thënë për ty  
nja dy urime.  
Kur gruaja gruas i lëshon namë  
i thotë: -Të pafsha me ortake!  
ndërsa Shtëpia juaj Botuese  
u bafte si lulja ndër livadhe!  
Kështu i heshtur,  
punëshumë,  
dibran i pastër si qiell vere,  
ti e di mirë  
më shumë se unë,  
që enët bosh bëjnë potere...  
Për ty, Bujar, fjala më e mirë,  
fjala më e ëmbël  
më duket pak,  
prandaj po shpreh me shumë dëshirë  
M&B e juaja  
qoftë me fat!

## Një libër kurajoz e sigurisht me vlera

Libri "Golloborda në optikën e kohës" me autor Velo Cfarku që përballet me lexuesin, veçanërisht atë gollobordas, u bashkëngjitet librave të pakta që kanë parë dritën e botimit deri tani për këtë trevë verilindore të vendi e banorëve të saj fisnikë që shekujve, kanë lënë largët të sotmen dhe të ardhmen. Si redaktorë të librit, që në fillim duhet të theksojmë se çdo pjesë e tij e botimi në tërësi ndonëse, me mozaikë të gjinive të publicistikës, me një përzgjedhje profesionale tematike të raportit mes gjinive, përshkohet nga një bosht i përvijuar qartë për atë që do të thotë autori, troç, pa dorashka, ashtu si e mendon, e gjykon, referuar bindjeve të tij, e sidomos dëshmi të protagonistëve që sillen. Autori profesionalisht, sidomos në zanatin e gazetarit, por edhe të studiuesit e polemizuesit me ata që kanë mendim të kundërt, mbron mendimin se "Golloborda nuk është etni e pastër shqiptare" dhe se "fshatrat dygjuhëfolës në pikëpamje të kombësisë janë maqedonas, gjuha e të parëve të tyre është maqedonishtja", se mendimi mbizotërues i deritanishëm i studiuesve se "Gollobordasit janë popullsi e lashtë shqiptare, se "gjuha maqedonase e bullgare janë zhargone të huazuara", për të (autorin) nuk është i saktë, etj. E në funksion të kësaj ideje, të këtij mendimi, autori polemizon me autorë të tjerë që mbrojnë të kundërtën, (pra që Golloborda dhe gollobordasit janë shqiptarë në trojet e tyre të lashta, e se gjuha shqipe është gjuha e tyre), duke sjellë dhe rrëfime e dëshmi në mbrojtje të tezës së tij. Duhet theksuar që në hyrje të këtij prezantimi se mendimi ynë si redaktorë të librit, përsa më sipër, pra për gjuhën dhe etninë e gollobordasve, është i ndryshëm me atë që mbron autori. Por njëherazi nuk mund të anashkalojmë kurajon e tij për të prekur në një farë mënyre një "tabu" të derivonëshme, të vlerësojmë punën që ai ka bërë në tërësi në këtë libër, përpjekjen për të sjellë nëpërmjet faqeve të tij unitetin mes gollobordasve e me të tjerët, emrin e mirë të gollobordasve në vend e jashtë tij në fushën e ndërtimitarisë, harmoninë mes feve e besimeve të ndryshme, mikpritjen, fisnikërinë, dashurinë për punën, cilësi që kjo trevë e banorët e saj i kanë bërë pjesë të natyrës së tyre në dekada e shekuj. E ritheksojmë se në këtë situatë, kur zërat ndryshe për gjuhën dhe etninë në një pjesë të Gollobordës (në atë dygjuhëfolëse) nuk janë më "në zë", kur tek ne ka dhe një parti legale që mbron mes të tjerave dhe "etnitë në Gollobordë", kur është botuar dhe një libër-projekt "Golloborda, realitete dhe probleme", përballë faktit që jo vetëm e drejta që të jep lëvizja apo qenia pjesë e botës së lirë, në këtë zonë, ka bërë që deri pjestarë të të njëjtës familje a të një fisi të paisen me dokumente të ndryshme (shqiptarë, maqedon, bullgarë), edhe ne si redaktorë të librit të Velo Cfarkut, nuk mund të "shiheshim" përballë një botimi përgjithësisht jashtë "shinave" të deritanishme për Gollobordën, në fund të fundit kurajoz e sigurisht me vlera. Të bindur se për sa serviren në faqet e librit normalisht, rreth disa problemeve që sjellë autori do të ketë dhe mendime të kundërta në të ardhmen, jemi të bindur se jo pak lexues do të përballen me shumë vlera që sjell libri. Ata lexuesit, do të njohin protagonistë, detaje, ngjarje interesante të Gollobordës e gollobordasve në shumë dekada, histori parë nën persiatjen e autorit që reflekton një intelekt, bagazh jetësor, njohje direkte të bashkrahinarëve e gjatë një eksperience të gjatë si kryeredaktor i gazetës "Ushtima e Maleve" (rreth 20 vjet), e për vite të tëra pune e jete si mësues e intelektual në Gollobordë e mes gollobordasve, në vendlindje, në Tiranë e gjetkë ku ata banojnë sot. Pra si çdo botim, edhe libri i Velo Cfarkut, për këto e të tjera që do të gjej lexuesi në faqet e tij, duhet përsëritur. Për më tepër, kur edhe pse me një histori të gjatë e të lavdishme të kësaj treve, edhe pse me intelektualë të shquar të fushave të ndryshme ndër breza, fatkeqësisht sot gjenden pak të dokumentuara (shkruara) ku vetëm librat për këtë zonë nuk bëhen sa gishtat e dorës. Në librin "Golloborda në optikën e kohës", nëpërmjet penës së Cfarkut, lexuesi do të njihet me refleksione, përsëritje të autorit në evenimente të rëndësishme për vendlindjen, publicistikë e mirëfilltë, tregime, intervista dhe biseda me bashkërahinarë e personalitete të ndryshme, studime, trajtësa, shënime udhëtimi etj. E veçantë në këtë mozaik publicistik, është se autori është i kursyer në fjalë,



për të sjellë për lexuesin më të rëndësishmen, më esenciale, atë që evokon vlera, të kërkoj, të gjej e të sjell të mirën, mesazhin që bashkon e jo përçan. Faktin a të vërtetën që është ndrydhur (sipas autorit!), solidaritetin e gollobordasve mes njëri tjetrit e të tjerëve në gëzime e fatkeqësi, të evokoj figura e personalitete që për shumë shkaqe e arsye janë lënë disi në "hije," deri tani, të risjellë legjenda apo ndodhi të zonës në një këndvështrim tjetër përsa njihen së shumti në opinion, etj. E mbi të gjitha, në rëfimin e drejtpërdrejt, këtë e bën duke qenë zotërues i mendimit e fjalës. E kjo sigurisht që është një nga meritat e autorit. Ndër të tjera në librin e autorit Cfarku, lexuesi do të njihet me vepra e mjeshtrë duarartë gollobordas, të cilët me artin, punën e tyre ndërtuan Shqipërinë e botën, ndonëse lanë shumë mangut në shtëpitë e tyre e kurrë nuk u lanë hapësirat që meritonin. Do të njihet me emra të njohur të ndërtimitarisë e administratës shqiptare si Rahman Hanku, mik i njohur i ndërtuesve duarartë gollobordas që pohonte se "E kam për nder të jem gollobordas!" Falë njohjes së realitetit, qënjes protagonist në shumë ngjarje e evenimente që përshkruan në libër, sjelljen e burimeve të gjalla për të argumentuar atë për të cilën ai ka bindje, për mendimin tonë, autori ia ka arritur mjaft mirë të ndërtojë e të vendosë urën e domosdoshme të komunikimit me lexuesin e çdo moshe e formimi intelektual. Sigurisht "karta" e bagazhit të gjatë jetësor, ka qenë një ndihmesë e fuqishme për konstruktin e librit "Golloborda në optikën e kohës". Së fundi duke përgëzuar autorin për sa ka materializuar në këtë libër, që natyrshëm mund të ketë edhe vërejtje si çdo botim i kësaj natyre, duke i uruar suksese në krijimin e mëtejshme publicistike e në të mirë të komunitetit, shpresojmë që jo vetëm ai, por dhe krijues të tjerë të Gollobordës e miq të tyre, të shkruajnë sa më shumë për këtë trevë me emër, se ajo është "thesar i panjohur" e ka shumë për të nxjerrë në dritë. Por gjithmonë me etikë, me qëllimin e mirë, me tendencën për t'ua afruar sa më shumë të jetë e mundur të vërtetës duke u konsultuar e përdorur me realizëm dokumentin zyrtar, arshivin, dëshminë e njerëzve të gjallë, me synimin për të nxjerrë sa më në pah historinë e lashtë e të re të Gollobordës e gollobordasve me gjurmë të vlefshme në historinë kombëtare shqiptare, traditën, kulturën e saj. I dashur lexues, kushdo mund të jetë përfshirë në këtë ftesë-mision të sinqertë.

**Eduard Abazi  
Kujtim Boriçi**

### Reklamoni biznesin tuaj!

Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!

Tel. 068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.

Email: lid\_gazeta@yahoo.com





Nga HAJRI MANDRI\*

**E**dukimi estetik në shkollë është një kërkesë e kahershme e shoqërisë njerëzore. Platoni kur flet për marrëdhëniet e individit dhe njohjes me të cilën përballet në jetë, mendon se personazhet negative, aktet kriminale në letërsi në mënyrë indirekte, bëjnë ftesë për imitim. Me zhvillimin e kulturës dhe të artit, fillon të funksionoi institucioni i censures, përfashtimi dhe lejimi i veprave letrare sipas një kriteri të caktuar moral, estetik, politik apo filozofik.

Në shoqëritë postmoderne, aktualisht në sistemin demokratik që përbën një sistem plural qarkullimi dhe konsumi të vlerave estetike, ndeshemi me koncepte të reja që kanë të bëjnë me edukimin estetik në shkollë.

Edukimi estetik i nxënësit realizohet paralelisht në dy plane; e para dhe më e rëndësishmja është shkolla, ku ka përqendrim të lartë të përthithjeve të idealeve estetike të cilat formojnë shijen dhe rrisin shkallën e perceptimit dhe përvetësimit estetik, dhe e dyta është faktori jashtëshkollor, vetë jeta që ndikon me burime të shumta të informacionit kulturor. Në këtë shkrim do të ndalemi vetëm në problemin e formimit të idealit estetik përmes programit mësimor dhe veprimtarive kulturore që organizon shkolla.

Nëpërmjet lëndës së letërsisë, filozofisë, historisë së artit etj., tek nxënësit arrihet formimi teorik i plotë, pasi njihen me koncepte që në teorinë e estetikës përbëjnë një trinitet: e vërteta, e mira, e bukura. Veprat letrare, në vështrimin estetik i përfshijmë tek artet ideo-shqisore. Në këtë kuadër, kur themi "një pikurë e bukur", tingëllon më e besueshme se "një roman i bukur", mund të themi "një roman i arrirë", i mirë, i pëlqyeshëm". Zakonisht termi "e bukur" përdoret si sinonim i vlerave estetike. Koncepti "kjo poemë, apo tregim kanë vlerë estetike" do të thotë në mënyrë eksplicite se ato na pëlqojnë apo na japin kënaqësi kur i lexojmë. Vlerat estetike mbeten relative, ato janë efektive në raport me mjedisin shoqëror, në nivelin e shijes individuale apo kolektive dhe sa kohë ato kryejnë funksionin e emetimit të kënaqësisë estetike. Filozofi dhe esteti i shquar gjerman A.G. Baumgarten thotë se "qënia vetë është e bukur atëherë kur shfaqet, shkëlqen, ndriçon ose kur është e proporcionuar, e harmonishme, e strukturuar". Brenda këtyre kriterëve, ne, në mënyrë intuitive, befasohemi në jetë dhe ndjehmë kënaqësinë që na jep e bukura në art ose në disajnimin industrial dhe strukturën arkitekturore të mjedisit ku banojmë. Shoqëria njerëzore investon për të krijuar vepra me vlera estetike si pasuri e çmuar e jetës

## Mbi edukimin estetik në shkollën e mesme

shpirtërore. Përjetimi estetik i jetës në mënyrë sa më intensive është synimi suprem i njeriut. Vlerat estetike nuk kanë përsosmëri, ata mbeten vlera midis vlerave të tjera të jetës. Vlerat estetike dhe vlerat morale bashkëveprojnë dhe krijojnë një qëndrim interaksionist, si qëndrim i gërshetuar mes dy vlerash. Prandaj mësuesit janë të vetëdijshëm për një edukim komplementar të personalitetit të nxënësit. Në mënyrë të veçantë mësuesit e letërsisë në shkollën e mesme kanë parasysh rolin që luan letërsia si lëndë, në pasurimin e përfytyrimit estetik. Për aftësimin e jashtëzakonshëm që ka materiali letrar për të na nxitur përfytyrimin, le ta ilustrim me një ese të Shellit, i cili thotë: "Përfytyrimi është instrumenti i madh i mirësisë morale dhe poezia e luan këtë rol duke vepruar mbi shkaqet, prandaj zakonisht thuhet se nëpërmjet letërsisë së madhe ne e ndjehmë vehten të bartur përtej kufinjve të jetës sonë të zakonshme, në një botë mendimesh dhe ndjenjash më të thella dhe më të larmishme se bota në të cilën jetojmë, se nëpërmjet letërsisë së madhe, ne mund të përjetojmë raste, mendime dhe ndjenja të njerëzve që ndodhen shumë larg nesh në kohë dhe në hapësirë". Në këtë rast kemi katërcipërisht përputhje të synimit dhe objektivitetit të programit të lëndës me realizimin e idealit të ri estetik tek nxënësi i cili përmes kryeveprave të letërsisë botërore dhe ato shqiptare, zbulon natyrën e përbashkët njerëzore që ekziston tek të gjithë njerëzit, mbraja fasadës së doktrinave që na ndajnë, dhe pikërisht me anë të kësaj rruge mund ta bashkojmë njerëzimin shumë më mirë se sa vetë doktrinën. Letërsia e fiksionit nxënësin e bën atë një personalitet integral me tendencë komparatiste dhe e largon nga instiktet e ashpra kriminale, nga pasionet e shfrenuara dhe akte që deformojnë integritetin e tij moral, shoqëror dhe estetik. Në analizën letrare të veprave me fikcion (fikcion-trill) mësuesi ka shanse të të pasurojë dhe të konfigurorë një larmi imazhesh, idesh, dhe të verë në lëvizje imagjinatën dhe përfytyrimin estetik, duke e bërë orën e mësimit mjaft tërheqëse dhe interesante, duke hapur dialog dhe debat me teza në mënyrë të shtjelluar (eksplicite) dhe në mënyrë të tërthortë (implicite). Roli i mësuesit këtu është tepër i rëndësishëm në shpjegimin e domethënies së tekstit dhe modërimin interpretativ duke i bërë pjesëmarrës edhe vetë nxënësit. Në romanin "Zonja Bovari" të Floberit kemi një shembull të shkëlqyer të deformimit të individit drejt një shkolle me edukim sentimental, ku ideali romantik e largon personazhin, vazhën e bukur, nga bota reale dhe e motivon drejt hapësirave ireale, të pa realizueshme në jetë, që e bëjnë njeriun asket, e largon nga bota reale e lumturisë që vjen nga puna dhe përpjekja e vazhdueshme e njeriut për t'u përsosur në jetë. E vështruar çështja e edukimit në aspektin estetik, pa bërë fjalë për edukimin moral, i cili është shumë i gjërë, duhet të përmbahemi në edukimin e mo-

titiv si ideal estetik dhe ndjenjave si refleksion i përvetësimit estetik që buron nga objekti estetik apo veprimi estetik. Në këtë kuadër do të ndalemi në dy variante: edukimi i ideve, motiveve, aftësisë interpretative të nxënësit që përbëjnë idealin estetik dhe ndjenjave pozitive që shkaktojnë dukuritë estetike, siç është kategoria e së bukurës, që e gjejmë më të theksuar në lëndën letërsi, histori arti, veprimtaritë artistike në shkollë, si konkurset e recituesve, koncertet me këngë valle, vallëzime të ndryshme, ku vetë nxënësi bëhet objekt dhe subjekt estetik. Sa më shumë nxënësi i shkollës së mesme të jetë pjesëmarrës aktiv në një mjedis artistik aq më shumë efekt ka në pasurimin e ndjenjave të tij. Përpara veprave letrare të arrira artistikisht nxënësit provojnë kënaqësi estetike. Në rastin kur gjatë një recitimi, nuk respektohet intonacioni, logjika artistike, kadenca e vargut, theksi tonik, ritmi i brendshëm, arsyetimi logjik, depërtimi në motiv dhe ide, plazmimi interpretues, atëherë nuk na ngjall kënaqësi estetike dhe themi jemi përpara një interpretimi të dobët. Në këtë rast nuk funksionon marrëdhënia midis objektit estetik dhe subjektivitetit, receptioni është inefficent, lidhjet e elementit ndijor-shqisor emocional dhe elementët racional nuk realizojnë një vlerësim estetik pozitiv. Mësuesi ndërhyr tek nxënësi kur lexon dobët një poezi pikërisht se prishen këto raporte. Letërsia për vetë specifikën si lëndë ka nevojë për një përjetim emocional. Kjo nuk realizohet në mënyrë artificiale apo sepse e vëmë si detyrë në një orë mësimi, por ajo vjen krejt natyrshëm në mënyrë intuitive (intuita siç dihet është ndriçim momental i ndjenjave dhe i mendimit) Në këtë vështrim, mësuesi si udhëheqës i procesit në zhvillimin e analizës dhe komentit, nxit katalizatorët aksiologjik (vlerësues) të përvetësimit estetik duke i drejtuar nxënësit drejt idealit social-estetik. Ideja që del gjatë komentit natyrisht është parakuptim që përgatit idealin social-estetik. Po në vetvete ç'është ideali?! Ideali është aftësia e njeriut për të projektuar veten në të ardhmen, për ta përfshirë në strukturë, në marrëdhënie dhe dukuri të mundshme, në përputhje me synimet e tij, dëshirat dhe aspiratat që kushtëzohen nga realiteti që ka përfshirë atë. Në vështrimin teorik ideali estetik është dominant i që organizon ndërgjegjen estetike të çdo epoke në një shoqëri të caktuar, si një përfytyrim i një realiteti të mundshëm. Ideat përpunohen, s'ka ideale të përjetshme, mbarënjëzore. Synimi antientropik, synimi drejt përsosmërisë është baza objektive e idealit estetik. Në lëndët e tjera shoqërore si historia, njohuri për shoqërinë, apo sociologji, kur gjatë mësimit arrijmë në konkluzione të tilla që nënkuptojmë motivimin dhe nevojën tonë dhe të mbarë shoqërisë, për të lëvizur drejt një forme më të lartë të organizimit social, drejt përsosjes së harmonisë sociale, dhe raporteve midis shoqërisë dhe individit, (p.sh. ideali demokratik si rendi shoqëror më i lartë që kërkun përsosje të vazh-

dueshme), ne kemi arritur që brenda këtyre ideve të realizojmë dhe idealin estetik, i cili ka vënë në lëvizje imagjinatën estetike, përfytyrimin estetik, dhe frymëzon motivin tek nxënësi. Në analizën e një drame përmes ndeshjes së personazheve, ne duke kërkuar të arrijmë tek ideali etik, si përsosmëri morale, realizojmë idealin estetik përmes modelimit strukturor që ndihmon pastrimi dhe pasurimi i ndjenjave. Duke vështruar një shfaqje teatrale, ne provojmë ndjenjat e bukura, të trishtuara, dhembe, gëzim, krenari dhe urrejtje sipas akteve dhe protagonistëve dhe vetë zgjidhja na çon tek modeli i idealit estetik i cili formatohet në ndërgjegjen tonë. Kur nxënësit shkojnë të organizuar në një disko, ne realizojmë edukimin estetik përmes ndjenjave të bukura, të përjetimit të një gjendje emocionale të gëzuar që realizohet nga shumë komponente, siç është dhe kryesori, muzika ose efektet e tjera skenike. Muzika në këtë rast, nuk është thjeshtë vibracion akustik-fizik, por është frymë, tërësi e organizuar tingujsh, që perceptohen prej veshit, por që vepron me këtë substancë në ndërgjegjen e nxënësit, duke pasuruar shijen dhe krijuar kënaqësi estetike. Në këto aktivitete shkollat duhet të bëjnë kujdes që elementët të tejkalojnë për moshën shkollë si pop arti, ap arti, letërsia pornografike që kërkojnë të venë në veprim elementët fiziologjikë për të krijuar kënaqësi estetike, të kufizohen me bindjen e plotë sepse ato çenojnë formimin e idealit estetik që synon programi shkollor. A shërben vetë mësimdhënësi një model për nxënësin? Dimë që njeriu nga natyra është i prirur të pëlqejë imitim. Në këtë rast mësuesi përbën një status special, ai duhet të edukojë tek nxënësi edhe me qëndrimin, sjelljen, fjalorin, paraqitjen, marrëdhëniet me faktorët të jashtëm që e kompromentojnë atë. Plotini thotë se bukuria ndeshet jo vetëm tek gjërat e para dhe të dëgjura por dhe te karakteri i mirë dhe sjellja e mirë, si parametra të sistemit estetik nga burojnë ndjenjat e simpatisë apo urrejtjes, të kënaqësisë apo të pakënaqësisë. Që shkolla të bëhet një mjedis që të ngjallë kënaqësi estetike tek nxënësit, dmth. ndjenjën e së bukurës duhet të plotësojë kushtet e estetikës së sotme bashkëkohore, të zgjojë interes, shpirtëror, duke realizuar parametrat e përkryerjes dhe tërësisë, harmonisë midis pjesëve, (lëndëve), strukturës, psikologjisë së sjelljes, dhe gjykimin normativ, rregullin, disiplinën, shkëlqimin e formës, mjedisit, paraqitja e jashtme, veshja etj. që përbëjnë mikroambjentin edukues. E rëndësishme është që ideali estetik në shkollë të mbahet parasysh në principet bazë të punës së drejtorisë së shkollës. P.sh. ideal estetik mund të konsiderohet afirmimi dhe konsolidimi i idesë se të vazhdojë shkollën e mesme të përgjithshme do të thotë të synosh për të vazhduar studimet e larta për t'u kualifikuar më tej në një fushë të caktuar. Ky paracaktim i objektivitetit personal tek nxënësi zhvillon imagjinatën dhe fantazinë e tij

dhe e tërheq atë nën ritmin e një ideali që projektohet si një ëndërr e bukur, e cila e motivon atë drejt suksesit. Kjo lidhet me ecurinë në shkollë, me punën vetjake, përgatitjen ditore të nxënësit, por edhe nga motivimi i faktorit mësimdhënës, sjelljes dhe veprimtarisë mësimore — edukative që zhvillon shkolla. Në bazë të teorisë së shijes estetike, njeriu ka një shqisë të brendshme për përvetësimin estetik. Shfrytëzimi i kompjuterave, informacionet nga interneti, media, enkartat, emisionet enciklopedike kulturore, krijojnë një përzierje adeguate të uniformitetit me varjetetin dhe krijojnë shqisën e së bukurësisë sotme moderne e cila kontrollohet nga shqisa e brendshme e nxënëseve, që sipas studiuesit anglez Hatçeson u quajt si shqisë e së bukurës. Edukimi estetik është pjesë përbërëse e filozofisë së shkollës së sotme moderne. Formimi teoriko-kulturor i nxënëseve në shkollat e mesme të përgjithshme duhet të arrihet përmes synimeve të qarta dhe objektivave të matshëm. Një gjykim estetik deduktiv e transhendent e gjejmë edhe gjatë mësimit të lëndëve natyrore. Kur bëhet fjalë për diçka të pamatë (hapsira qiellore, drejtëzat, pafundësia e materies fenomenet natyrore etj., atëherë përfytyrimi ynë dorëzohet sepse nuk e përballojmë detyrën për ta rrokur dukurinë në tërësi, kështu duke u bërë të ndërgjegjshëm për supermacinë e arsyes na vjen në ndihmë përfytyrimi i të madhërishmes, si kategori estetike. Ose kur shpjegojmë shkaqet e një katastrofe që i kalon aftësitë e njeriut për t'i përballuar atëherë reflektojmë në arsyetimin për të qenë të ndërgjegjshëm për dinjitetin tonë si qenie me moral. Në këtë rast kemi të bëjmë me kategorinë estetike të tragjikes në jetë.

Informacioni lëndor në shkollë, ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin dhe pasurimin e imagjinatës tek nxënësit. Sa më të zhvilluar ta ketë imagjinatën një nxënësi, aq më cilësor është në përvetësimin e dijeve. Imagjinata thotë Kollrixhi, është aftësia bashkuese që i shpërbën të dhënat, i transformon dhe rezultati që nxjerr është një cilësi e re.

Nëpërmjet edukimit estetik në shkollë, ne realizojmë një komponent të fuqishëm në formimin e gjithanshëm të personalitetit të nxënësit si qytetar i denjë i një shoqërie të kulturuar e të demokratizuar, duke e shpëtuar atë nga interpretimet intuitive që zakonisht udhëheqin individët me nivel arsimor të pamjaftueshëm. Edukimi estetik në shkollë tashmë nuk është doktrinë, ajo është tërësia dhe esenca edukative e programit mësimor- edukativ, në përputhje me traditën, me kulturën dhe realitetin psiko-moral të popullit tonë. Liria e gjykimit dhe e mendimit estetik është e lidhur me pranimin e diversitetit kulturor, të bashkëjetesës së koncepteve estetike, të përpunimit të shijeve të veçanta dhe të përbashkëta, konvergimi dhe divergjimi kulturor, si bazë e filozofisë së sistemit tonë demokratik.

\* Drejtor i shkollës së mesme të përgjithshme "Gramoz Palushi", Babrru, Tiranë

# E BUKUR ËSHTË LURA, OR ARBENI I VLADEVE!

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Një SMS në celularin tim. Në kërkesë e pazakontë. Po e përcjellim si një dëshirë njerzore për të njohur vendlindjen. Jo vetëm Lurën por të gjithë trevat e të. Po e përcjellim me dëshirën që në celularin tonë kërkesa të tilla të na vijin përditë duke hapur kështu një bisedë të gjërë, bisedën "Të njohim Dibrën". Ai shkruan:

**"Ju lutem, shkruani diçka për bukuritë e natyrës së Lurës. Ai që nuk njeh Lurën nuk njeh Shqipërinë. Nga Arben Vladi, Lurë. Cel. 00306943039760, 8 prill 2007, ora 14.16.**

I dashur Arben! Ju faleminderit për kërkesën. Meqë e njoh Lurën, jo vetëm natyrën por edhe njerëzit e saj, do të desha të të marr "përdore" dhe së bashku të udhëtojmë mes natyrës dhe njerëzëve të saj. Nuk e di nga cilët Vlade je, nga ata të Fushë Lurës, Lurës së Vjetër, të Pregj Lurës, Borie Lurës, Armallës... Ke të bëjsh me doktor Ndrecën dhe nënën e tij burrneshë Dilën? ...Ke të bëjsh me atë lirin e moçëm të Vladeve, Dodën në qendër të Lurës? Ke të bëjsh me Arif Vladin, korifeun e këngës epike shqiptare?

Oh, edhe unë çfar pyetje bëj. Ti je një Vlad, je një filiz nga rrënjët e moçme të një fisi të njohur dhe kjo më mjafton...

Nuk e di nga ke dëshirë t'ia nisim, ku t'i kërkojmë rrënjët e degat e bukurive të Lurës? Të ngjitemi asaj të përpjetës që të çon në Lanë-Lurë, të mbushim duart me ujën e burimit dhe të kthejmë fytyrën prapa dhe të shohim si zbardhojnë kullat që nga Borie Lura e deri në Lurë të Vjetër? Apo don të ngjitemi në Lanë Lurë, ti bijem mospërmas atyre livadheve e diku në anë, atje ku fillon pylli të mbushim duart me luleshtrydhe e mjedra që të dehin nga aroma? Apo don të zbrësim pyllit të Nikës, të pijmë një kafe në kullën e Rajteve, ulur këmbëkryq siç që ulur shtatëdhjetë e ca vjet më parë plaku i maleve Bajram Curri? A mos doni të mbledhim një tufë me luleve e t'i vendosim në lapidarin e Dom Nikoll Kaçorrit, burrit të madh të Lurës që i dha krahun e tij krahut të plakut të Vlorës Ismail Qemalit për të ngritur flamurin më 28 Nëntor 1912? A mos doni të ngjitemi në Pregj Lurë dhe të pijmë një kafe në një kullë vladesh në krye të fshatit duke kundruar si në një ballkon tërë pamjen në perëndim, pamjen që dominohet nga Guri i Kuq lart, Vlashaj e Arrmolla poshtë?

Nuk ma do mendja që të mos duash t'i biësh mospërmas Borie Lurës, të ndalesh paksa në kullat e Hotit dhe duke lënë pas një bukuri të zbrësesh e të kapësh një tjetër bukuri, atë të Gurë-Lurës. Me siguri do të deshe të ulesh në një odë në lagjen Thanë e të pije një gotë me raki kristal të pastër thane që nuk është vetëm pije por edhe ilaç. Mos don të zbrësesh poshtë, të shohish se si buron nga një shkëmb-shpellë disa metra lart Seta, si asaj i është vënë pritë dhe e kanë detyruar të çajë Gjalicat e ujërat e saj të shkojnë deri në Reç, të ngjiten në Sinë, të kalojnë Drinin e të shkojnë deri në Fushë-Çidhën e Kastriot? Këtu kam frikë të të marr përdore e të të kaloj nëpër rrëpirën shkëmbore të Gjalicave. Kam frikë sepse rruga është kaqe e rrezikshme sa nuk të mbaj dot po t'u morën mendët. Mua, një herë të vetme që kam kaluar, një bashkudhëtar deshi të më jap dorën. Në vend të dorës i dhashë çantën dhe aparatin fotografik. Duart i vura në pjesën e sipërme të sh-



Liçeni i Luleve. Foto: Gazmend Kërkuti

këmbit ndërsa këmbët i këmbëja mbi një drrasë mbi humnerë njera pas tjetrës siç këmbehen kur don të matësh një distancë me gjatësinë e këpucëve. Aty, në vitin 1967 është shkruar faqia më e bukur e heroizmit të ndërtuesëve dibranë të veprave ujore, të inxhinierëve popullorë pa diplomë, të Gani Tuçepi që e piketoi kanalin me karabinë gjermane dhe të Beqir Kalisë që e zbatoi atë duke çarë tunele e shkëmbinj. Ndoshta ndonjëherë, poshtë në Çidhën, do të ngrihet një digë hidrocentrale e liqenit që do të kapë Gurë Lurë do të lundrojnë varka. Ndoshta ndonjëherë nga Çidhna do të nisë drejt liqeneve të Lurës ndonjë teleferik... Atëhere njerëzit, duke ngritur kokën lart në atë tunel maresh, do të vlerësojnë se sa heroike dhe madhështore ka qenë ajo ndërmarrje e guximshme e gushtit 1967...

...Mos u frikso. Nuk dua të të largoj nga Lura, nga bukuritë dhe njerëzit e saj duke të zbritur në ultësirat e Drinit. Po kthehem mbrapsht dhe po të ngjis tek liqejt, tek ajo bukuri që i ka dhënë emër Lurës e që ti thua se "Ai që nuk njeh Lurën, nuk njeh Shqipërinë". Ku don të ulemi e të shtrohemi në qilimin e blertë të natyrës? Don të ulemi në atë lëndinën që rrok liqenin e Luleve? Don të matim me pashën e katër burrave diametrin e atij armenit të madh që në mëngjes e përcjell hijen e vet tek liqeni i Gallabës apo don të pijsh një ujë të ftohtë në atë burim e vogël dhjetë metra larg rrugës? Po të duash ulu. Unë ende nuk jam lodhur. Po marr rrugën drejt e pas disa lëndinash po ulem në Fushën e Pelave. Atje ma ka anda. Ajo është bukuria e bukurive të Lurës. Për mua kjo fushë në fole të qiellit të pishave është më e bukura dhe më e begata. Thonë se fusha e ka marrë emrin se Skënderbeu këtu mbarshonte pelat, e kishte burim të pashtershëm të kavalerisë së tij që për njëzet e pesë vjet nuk njohu kthim prapa...

Po më ndjek prapa? Do të lodhesh sepse mua ma ka qejfi ta shoh bukurinë e Lurës, jo nga poshtë por nga lart. Kështu po marr një të përpjetë malore, një kreshtë thikë të mbrehtë, kreshta që lidhura dorëpërdore formojnë atë që quhet Kunora e Lurës...

Poshtë, në perëndim, syri më ndalet tek Mali i Dejes. Nuk kam qenë atje por më kanë thënë se shkëmbejve të tij dalin aq burime sa grusht pas grushti mbushin një lumë, atë që i bie Zall-Gjoçajt mospërmas dhe derdhet në liqenin e Ulzës. Një peisazh që vetëm po të ngjitesh atje e jeton një çast për ta jetuar gjithë jetën. Bukuri të Matit e të Mirditës, burime në sofër në maleve, gjelbrim të përjetshëm të pishave e të armenit të bardhë, oaze livadhesh...

Ecim Kunorës së lartë duke u mbajtur vende vende këmbadoras. Poshtë, djathtas, liqenet e Lurës si gota kristali mbushur me shampanjën e natyrës. Liçeni i Luleve, Liçeni i Gallabës, Liçeni i Zi, më i thelli dhe më i bukur. Po ai sy i kaltër disa dhjetra metra mbi Liqenin e Zi çfar merr dhe i jep kaltërsisë qiellore? Çfar emri ka? Thonë se është pa emër. Nuk e besoj. E ka një emër siç e kanë të gjithë, emëra sipas pronarëve dhe legjendave. Nga Nezhda pëllëmba e dorës së natyrës mban Liqenin e Koçekut. Kështu e quajnë vendasit sipas pronës së fisit të njohur të Koçekëve. Është më i madhi dhe ndër më të bukurit. Ka edhe një legjendë për të, legjendën e Luri-anës, vajzës gjysëm njeri e gjysëm peshk, mbretëreshës së liqeneve të Lurës. Unë e kam dëgjuar disa herë, në disa variante. Nuk po e tregoj. Do të duhej një natë dimri përballë oxhakut në kullën luriane që të tregonim njerin nga variantet e legjendës.

Liçeni i Koçekut pak sipër tij ka një qilim të qetë ujqor, qilim me lule të cilin rrallë njerëz që qarkojnë bukuritë e këtyre maleve rrugës që nis në Fushë Lurë e nën tunelin e gjelbërt shkon për tu ndarë drejt Burrelit e Selishtës pak poshtë kështjellës së Skënderbeut, e shohin ashtu siç nuk shohin të tjerë oaze ujore në të gjithë perimetrin rrethues të tij. Ky quhet Liçeni i Lopëve. Sipas legjendës këtu ra një kope lopësh. Ra për të dalë në anën tjetër të malit, atje ku sot mirditorët i ftojnë njerëzit të kurohen në burime ujorash të ftohta minerale...

Na duhet të zbrësim nga maja e Nezhdës prej ku kullat e bardha në luginën nga Borie Lura në Lurë të Vjetër të

ngjajnë me varka me vela. Prej ku Runja e Lurës matet të kapë Korabin mëngjesëve kur lind dielli e mbrëmjeve kur perëndon. Prej ku edhe liqenet, edhe gjelbrimi, edhe njerëzit të hyjnë në zemër e në shpirt për të mos dalë tërë jetën...

Pas gjithë kësaj rruge nuk ka se si të mos ndalesh në Lurë të Vjetër, të ngjitesh në kullën e Morisenëve dhe Dedeve, të Islamit e të Gjonit të parët e të cilëve, vëllezër të një gjaku e gjinie ishin njeri katolik e tjetri mysliman, shembulli tipik i asaj që Pashko Vasa pat thënë dikur: "Feja e Shqyptarit asht shqyptaria"...

Lura është e bukur jo vetëm nga ana natyrore por edhe nga ajo shpirtërore, mardhënieve me njerëzit e vet. Ajo është një trevë e Dibrës, Bajraku i Nëntë Maleve të saj...

\*\*\*

I dashur Beni! E di që nuk ta dhashë Lurën ashtu siç e ke në shpirt ti, ashtu siç e kam në shpirt unë. Ta dhashë ashtu siç ishte shumë vite më parë, në ditë maji e qershori. Nuk ta dhashë në ditë dimri, në pamjen e saj të bardhë, me kullat që shndrohen nga varka me vela në anije me avull, me oxhaqet që nxjerrin tym e me vatrat e saj të ngrohta. Është një tjetër bukuri që kush e ka jetuar nuk e harron kurrë.

Ju, i dashur Beni, thoni se "Ai që nuk njeh Lurën nuk njeh Shqipërinë". Si luras që jeni keni të drejtë jo vetëm ta thoni por edhe t'i ftoni njerëzit. Unë, si njeri që më ka takuar në jetë të bredh shumë male e vende, të ngjitem në malet e Kacnisë dhe të "zbuloj" bukuritë e liqeneve të saj, të ngjitem në malet e Tërnovës dhe të ndalë vështrimin mbi pyjet dhe liqenin e Valikardhës, të ngjitem në Korab e të mbush duart me ujën e ftohtë të burimeve të Fushës së Ponairit, të udhëtoj luginës së Valbonës dhe të mbush mushkërit me flladin e bjeshkëve të Razmës, të shoh si llapashiten troftat në ujën e pastër të Shushicës, të ngjitem në Gjerbës të Skraparit e në Sheper të Zagorisë, të lag deri në brryl duart me ujqat e Borshit e të shijoj bukurinë e Jonit...unë, pra, them se "Ai që nuk njeh Shqipërinë, nuk njeh botën!"

E-mail: [a\\_ashiku@yahoo.gr](mailto:a_ashiku@yahoo.gr)  
00306938103747.

# Lutfi Hoxha, aktori dibran i 100 roleve

Nga Dr.ASTRIT HOXHA "Mësues i merituar"

Aktori i shquar i skenës dhe ekranit Lutfi Hoxha më 11 janar të vitit të ardhshëm mbush plot 55 vjet punë të palodhur si aktor profesionist i teatrit të "Aleksandër Moisiu" të Durrësit. Lutfiu rrjedh nga një familje e shquar patriotike, që emigroi nga Reka e Dibrës së Madhe për arsye të represionit serb. Lindi në Durrës më 1/6//1934. Në këtë qytet mbaroi mësimet e para të shtatëvjeçares dhe pastaj mbaroi liceun artistik "Jordan Misja" dega e aktimit. Shumë i ri në moshë u aktivizua në grupet e baletit dhe teatrit pranë shtëpisë së pionierit. Ra shpejt në sy për talentin e tij aktrikal dhe për këtë arsye e aktivizoi edhe teatri amator atëherë i Durrësit, i cili më 1953 u kthye në teatër profesionist. Që nga ky vit e deri në vitin 1989 Lutfi Hoxha ishte pa ndërprerje pranë teatrit "Aleksandër Moisiu", me përjashtim të viteve 1954-1955, kur iu desh të bëjë shërbimin e detyrueshëm ushtarak pranë estradës së ushtarit. Në këtë estradë Lutfiu u shqua, sidomos për monologët e tij, të realizuar me një mjeshtëri e humor shumë të këndshëm. Gjatë karrierës së tij të gajtë në teatër, ai ka realizuar mbi 100 role. Veçori dalluese e Lutfiut është fakti se ai ka qenë i sukseshëm si në komedi ashtu edhe në dramë, gjë që s'është gjithnjë e lehtë. Lutfiu ka interpretuar kryerole, por ka interpretuar edhe karaktere. Ka luajtur të riun por edhe plakun, madje edhe kur vetë ka qenë mjaft i ri. Por Lutfiu është aktivizuar jo pak edhe në kinematografi. Dhe fakt është se edhe këtu ka qenë mjaft i sukseshëm. Ka luajtur në 17 filma si në filmin "Detyrë e posaçme", "Shoku ynë Tili", "Pylli i lirisë" etj. Jeta e aktorit të talentuar dibran Lutfi Hoxha është e

lidhur me teatrin dhe kinematografinë. Dhe këtë e shikojmë edhe tashmë që ka dalë në pension.

Në dhjetë dymbëdhjet vitet e fundit ka luajtur në "Qytet pa dashuri" të Bashkim Hoxhës, "Trokitje në dyert e dhimbjes" shkruar dhe vënë në skenë nga Serafin Fanku, "Koncert i fjalës artistike" me rastin e 125 vjetorit të lindjes së Aleksandër Moisiut. Ka luajtur bukur monologun Edipit në "Edipi Mbret", "Nuk paguajmë, nuk paguajmë" të nobelistit Daroi Fo. Është për tu shënuar, se për të parën herë në historinë e teatrit të Durrësit ai luan dy role në të njëjtën pjesë. Siç thamë Lutfiu ka luajtur edhe dramën edhe komedinë por shkëlqimin më të madh e ka arritur në fushën e komedisë dhe sidomos me komedinë e Dionis Bubanit "Bileta e llotarisë" (1964). Në këtë komedi Lutfiu ka interpretuar rolin e xha Sokratit. Ja si e vlerëson këtë rol regjizori dhe "artisti i popullit" Gjergj Vlasi: "Lutfi Hoxha i ka dhënë personazhit të vet kaq veçori shprehëse, kaq forcë artistike, sa xha Sokratit mbetet një nga krijimet më të bukura jo vetëm të këtij aktori, por simbas mendimit tim, një nga krijimet e roleve komikë më të mirë, që ka krejt teatri "Aleksandër Moisiu". Me këtë rol në festivalin e teatrove profesioniste të atij viti, Lutfi Hoxha ka marrë çmimin e parë për interpretim të roleve të dramaturgjisë kombëtare. Shumë i sukseshëm Lutfi Hoxha ka qenë dhe në rolin e Skapenit në komedinë klasike "Dredhite e Skapenit" të Molerit. Figura e Skapenit është një figurë e lakmuar nga të gjithë artistët e mëdhenj dhe është në nderin e Lutfiut që këtë figurë e skaliti me aq mjeshtëri profesionale, dinjitet të madh e cilësi të lartë artistike. Me një nivel të lartë artistik ai ka realizuar edhe shumë role e kryerole si në dramaturgjinë botërore ashtu edhe në atë kombëtare. Për të gjitha këto



Lutfiu u bë një aktor i dashur jo vetëm për spektatorin durrsak por edhe për atë të të gjithë Shqipërisë. Luti nuk i ndahet skenës dhe ekranit. Roli i dajës së dy vëllezërve në dramën e Gjergj Vlashit "Dy vëllezër e gjysëm" është tepër interesant. Dhe këtë padyshim më interesant e bën vetë aktori Lutfi Hoxha. Po kështu dhe me dramën "Korbi i bardhë" shkruar dhe vënë në skenë nga Mihallaq Luarasi. Lutfiu lozi aq bukur sa dhe publiku artëdashës i Shkupit e vlerësoi si një aktor i përmasave të mëdha. Natyrisht që aktori i 100 e ca roleve Lutfi Hoxha edhe është vlerësuar me medalje si dhe urdhërin "Naim Frashëri". Vlerësimi më i lartë i është bërë aktorit dibranë Lutfi Hoxha me titullin "artist i merituar". Por jo vetëm kaq. Për aktorin Lutfi Hoxha shpesh ka shkruar dhe shqiptar ku kanë dhënë dhe vlerësime shokë dhe koleg të tij. Regjizori Haxhi Rama thotë: "Një gur i çmuar, që rrezaton ngado. Në përcaktimin e aktorëve zakonisht ata evidentohen nga një tipar dallues. Nëqoftëse do të kishte një çmim për njëjti fytyrat e aktorit, këtë padyshim, do ta kishte merituar Lutfiu. Ky është aktor i shumë fytyrave dhe shumë planeve. Ka luajtur me shumë sukses komedinë dhe dramën dhe i plotëson me mjeshtëri të dyja gjinitë. Në veçanti komedia e luajtur nga ai

janë mjaft të ndryshme nga njëra tjetra. Nikolin Xhoja ka dy tre elemente dalluese, por Lutfiu ngjan me një gur të çmuar, që ngado që ta rrotullosh ai rrezaton. Përveç dashurisë për teatrin, Lutfiu ka pasur edhe një disiplinë shembullore për punën" Mirush Kabashi "Ngjyrë në trupën teatrore të Durrësit Lutfi Hoxha ka qenë një ngjyrë në trupën e veçantë të teatrit "Aleksandër Moisiu" në kuptimin që ishte një aktor i karakterit. Duhet kuptuar që një aktor i karakterit përbën në teatër kurorën e profesionalizmit" Fadil Hasa "Pasqyrë e njeriut me zemër të madhe. Unë jam i brezit më të vonë në teatrin "Aleksandër Moisiu". Mes shumë aktorëve të nderuar gjeta edhe Lutfi Hoxhën. Gjatë ditëve të mia si profesionist mësova që Lutfi Hoxha ndonëse shumë i ri në moshë ishte një nga më të vjetrit e teatrit. Kjo më befasoi gjatë viteve në teatër. Lutfiu për mua ka qenë pasqyrë e një njeriu të mirë me zemër të madhe dhe më e rëndësishmja, një pedagog i mrekullueshëm në rrugën e mjeshtërisë së aktorit. Nëse sot krenohemi se jemi dikushi këtë ia di shumë faleminderit Lutfi Hoxhës. Tani që është në pension, kam mendimin që i takojnë të gjitha ato që parashikohen me ligj për një aktor me përmasa kombëtare"

## Mjeku dhe shkencëtari Faik Sharofi

Kur shkruajmë për portretin e mjekut virolog Faik Sharofi, na del përpara personaliteti, puna dhe vepra e tij e parë kjo si kontribut i dhënë në fushën e shkencës mjekësore të vendit tonë. Faik Sharofi ka qenë një mjek virolog i talentuar, i paisur me një kulturë profesionale të mirëfilltë dhe bashkëkohore, kjo dhe me një përvojë të madhe të fituar gjatë punës për disa dekada në Institutin e Higjenës dhe Epidemiologjisë (sot Instituti i Shëndetit Publik). Ai u përket atyre mjekëve të shquar të cilët pa marrë parasysh sakrificat i shërbyen me përkushtim dhe devotshmëri popullit dhe atdheut. Dr. Faik Sharofi ka lindur në Tiranë më 19.3.1936 në një familje me tradita patriotike dhe fetare. Prindërit e tij u shpërngulën nga Dibra e Madhe pas kryengritjes së shtatorit të vitit 1913, për t'i shpëtuar terrorit e masakrave të sunduesit sovjetik serb, pas ndarjes nga Shqipëria. Që në moshë të re u brumos me një edukatë të shëndoshë. Ndikim të madh në këtë drejtim pati babai i tij patrioti, studiuesi, poeti dhe "mësuesi i popullit" Haki Sharofi. Në vitin 1967 Faiku përfundon fakultetin e mjekësisë në Universitetin e Tiranës ku u dallua si një student serioz dhe mjaft kërkues ndaj vetes. Fill pas studimeve u emërua në Laboratorin Qendror të Prodhimeve dhe Kërkimeve Mikrobiologjike, në sektorin e vaksinave. Në vitin 1968 me një bursë të Organizatës Botërore të Shëndetsisë (OMS-it) u dërgua për një specializim në Institutin e Mikrobiologjisë Parasitare dhe Epidemiologjisë "Dr. I. Cantacuzino" në Rumanë. Pasi mbaron specializimin në mikrobiologji për diagnozën e sëmundjeve virusale, drejtor i Institutit Prof. Dr. Mesrobeonu, shkruan me shumë nderim për mjekun Faik Sharofi. Mbas specializimit kthehet përsëri në atdhe dhe

vazhdon punën në Institutin e Higjenës dhe Epidemiologjisë nga bashkimi i dy laboratorëve, atij qendror të Prodhimeve dhe Kërkimeve Mikrobiologjike dhe atij të Higjenës. Në Institutin e Higjenës dhe Epidemiologjisë sapo filloi punën mjeku Faik Sharofi u kujdes të sigurojë mjetet e nevojshme për punë të specializuar në studime të sëmundjeve virusale. Në vitin 1969 Dr. Faik Sharofi emërohet shef i repartit të virusologjisë. Këtë repart e ka drejtuar për mjaft vite duke çelur perspektiva të reja në diagnostikimin e sëmundjeve të ndryshme virale e rikeciale. Ai ka aplikuar për herë të parë në vendin tonë prodhimin e kulturave indore. Ngritja e laboratorit të gripit në vitin 1969 ka qenë sukses për Institutin e higjenës dhe Epidemiologjisë. Në këtë laborator filloi studimi i epidemive të gripit në vendin tonë. Në vitin 1969 Shqipëria u gjend përpara një epidemie shumë të madhe të gripit. Është puna pasionante, këmbëngulëse dhe përgaditja profesionale, që mundësuan mjekun Faik Sharofi, të arrijë të bëjë për herë të parë në Shqipëri diagnozën e virusit të gripit A/Hong-Kong/1/1968 shkaktar i kësaj epidemie. I takon direkt merita Dr. Faik Sharofit që edhe në kohën e tanishme, laboratorit i Gripit të Institutit Shëndetit Publik vazhdon aktivitetin si laborator reference dhe që ka lidhje direkte dhe me disa Qendra Ndërkombëtare të Gripit siç janë ajo e Londrës dhe Atalantës. Faik Sharofi në veprimtarinë e tij është treguar i papërtuar. Sa e sa herë, mjekun virolog Faik Sharofi do ta gjeje me shërbime jashtë Tiranës, aty ku sinjalizoheshin vatra dhe shpërthime të gripit e të sëmundjeve të tjera virale. Duke u njohur me situatën, studionte shkaku të sëmundjeve dhe mbas verifikimit në laborator të të dhënave merrte masat për të mos u përhapur de-

risa të luftohej e të shërohej edhe njeriu i fundit. Më pastaj në mjediset e laboratorit do të studionte gjatë, për të parë në se kishte vepruar me rrugën më të mirë dhe më të shpejtë, për zhdukjen e pasojave. Kështu do të merrej me studimin edhe të etheve hemoragjike, të poliomielitit, hepatitit viral etj. Ai së bashku me kolegët e tij të punës në repartin e virusologjisë, prodhuan në vend antigene dhe serume diagnostike si dhe shumë tretësira të ndryshme, që u përdorën me sukses kundër sëmundjeve virusale. Rreth viteve 1987-1992, Faiku tentoi të realizonte një punim tjetër madhor, siç ishte ajo e prodhimit të vaksinës së gripit në vend, çka kërkonte të derdhte shumë mund dhe djersë për qëllimin, që ai i kishte vënë vetes. Në saj të punës së madhe, të një vullneti të jashtëzakonshëm dhe të palodhur, u bë e mundur të përcaktoheshin metodikat bazë të prodhimnit të vaksinës si purifikimi e koncentrimi i virusit etj. Por kjo punë e madhe e vështirë nuk u përfundua për shkak të shëndetit të tij që filloi të përkeqsohej. Të gjitha këto punime e studime mjeku Faik Sharofi i ka paraqitur në kumtesa, si dhe në shkrime të botuara në buletina apo revista të ndryshme shkencore. Me vlerë është dhe puna studimore dhe hulumtuese në formën e një monografie e përgaditur nga Faik Sharofi me qëllim mbrojtjen dhe fitimin e një grade shkencore. Por për shkaqe biografike nuk arriti ta mbronte. Historia e shkencës botërore tregon raste, kur mjekë të pasionuar gjatë punës mund të infektohen nga sëmundjet infektive, madje kanë humbur dhe jetën. Edhe Dr. Faik Sharofi në vitin 1976 do të kalonte sëmundjen e Hepatitit në formën e tij më të rëndë që për pak desh i mori jetën. Tregojnë kolegët e tij që këtë infektion e mori




gjatë një pune shkencore në Institut. Për t'u mbrojtur nga sëmundjet virusale Dr. Faik Sharofi këshillonte të mbahet pastër mjedisi, për të evituar kështu shpërthimin e sëmundjeve ngjitëse vdekjeprurëse. Është për t'u theksuar, që detyra e mjekut për Faik Sharofin, ka qenë ajo e një njeriu human dhe me zemër të gjerë. Ai është treguar i palodhur dhe i papërtuar për t'u shërbyer të gjithëve që kishin nevojë për këshillat e tij me mjaft vlera. Jeta e Dr. Faik Sharofit është shuar në moshën 61 vjeç, në mbrëmjen e datës 12 dhjetor të vitit 1997. Vdekja e parakohshme ishte një humbje jo vetëm për familjen, të afërmit por dhe për të gjithë ato njerëz që u shërbeu me përkushtim, humanizëm dhe dije shkencore. Humbja e Dr. Faik Sharofit ishte një humbje e madhe edhe për vetë shkencën shqiptare.

Islam Sharofi

# Dibranët kampion në mundje

Vitin 2007 e lamë pas dhe tashmë ja tek po troket viti 2008. Analiza të shumta janë bërë dhe do të bëhen. Dikush analizon dobësitë dhe dikush me të drejtë u mburret arritjeve gjatë vitit që shkoi. E një ndër to që shkelën kryelartë në vitin 2008 janë padyshim dhe ekipi i mundjes së klubit sportiv "Korabi". Dikur në klubin sportiv "Korabi" dy epike ishin ato që ia rrisnin emrin më shumë këtij klubi: Volejboli e mundja. Tashmë volejboli sikur nuk ndjehet mirë dhe për këtë ka vite që lëngon. Ekipi i mundjes jop vetëm tani por ka më shumë se njëzet vjet që njih vetëm arritje. Për këtë shifrat flasin vetë e faktet janë kryeneçe. Asnjëherë nuk ka humbur por përkundrazi po ngjitet për herë lart e më lart. Është pra sot për sot ky ekip që nderon jo vetëm klubin sportiv "Korabi" por të gjithë sportdashësit dibranë kudo që ndodhen. Disa vite me radhë ekipi i mundjes shpallet kampion dhe merr vlerime dhe nga federata e mundjes. Kështu dhe në analizën vjetore që bëri para pak ditësh në qytetin e Lezhës kjo federatë fjalët më të mira ishin padyshim për ekipin e "Korabit" si një ekip me vlera që premtan më shumë në të ardhmen. Ekipi i mundjes së "Korabit" prej disa vitesh është kampion në mundje në peshë të ndryshme e moshë të ndryshme. Ajo që padyshim ia kanë rritur vlerat këtij ekipi janë më të rinjtë të moshës 12 deri në 20 vjeçarët të cilët kanë përfaqësuar jo vetëm "Korabin" por dhe kombëtaren tonë në aktivitetet jashtë vendit si në Selanik, Prizren apo dhe Shkup. Ekipi i mundjes së klubit sportiv "Korabi" ka rritje nga viti në vit por të gjitha këto rezultate, diploma apo medalje që ka marrë padyshim që është një meritë e veçantë e trajnerit të mundjes, "Nderi i sportit shqiptar" zoti Fiqiri Rama. Dhe Fiqiri nuk ka pak që është trainer i këtij ekipi por afro njëzet vjet dhe njëzet vjet nuk i thonë pak që ekipi i mundjes së klubit sportiv "Korabi" të jetë ndër më të mirët në vend. Duke parë aftësitë e Fiqiri Ramës në mundje të lirë Federata e mundjes shqiptare në mjaft aktivitetet jashtë vendit Fiqirit i besohet drejtimi i ekipit kombëtar dhe falë këtyre aftësive gjithmonë ka korrur suksese të një pasnjëshme. Vetëm për vitin 2007 ekipi i mundjes së klubit sportiv "Korabi" solli në Peshkopi 4 medalje ari, 2 argjendi dhe 4 bronxi. Nuk është pak për një ekip si "Korabi" të klasifikohet si një ndër ekipet më të mirë në analizën vjetore të bërë nga Federata e mundjes në qytetin e Lezhës. Fiqiri edhe kur ka qenë trainer me ekipin kombëtar të mundjes ka patur mjaft të rinj nga Dibra që janë ndeshur me të huajt dhe kanë korrur suksese. Kështu vlen të përmenden Fatjon Vishka që mori medalje ari në Shkup, Arsen Spahiu medalje ari në Shkup, Vladimir Zajmi medalje ari në Shkup, Imirjan Rabdishti medalje ari në Shkup, Bajram Mani medalje të argjendit në Prizren, Arsen Spahiu medalje të bronzit në Prizren, Sozhoman Sejfullai medalje të bronzit në Prizren, Ilvert Doçi medalje të argjendit në Selanik dhe medalje të bronzit në Prizren. Besojmë se nuk janë pak medalje brenda vitit 2007 për ekipin e mundjes të "Korabit" që solli në Peshkopi 23 medalje ku 4 nga Selaniku, 7 nga Shkupi e 12 nga Prizreni. E domosdo Fiqiri Rama nuk mund të bjerë në eufori për atë që ka arritur deri tani qoftë nga ekipi i mundjes së "Korabit" qoftë dhe kur drejton ekipin kombëtar. -Federata e mundjes ndjehet në vështirsi gjithmonë, thotë Fiqiri sidomos në që punojmë në Peshkopi. Mungesat janë të shumta sa që po bëhen të përbalueshme nga ana jonë. Dalngadalë po rritim një brez që nesër do të jap më shumë jo vetëm ekipit të "Korabit" por dhe vetë Federatës së mundjes shqiptare por kur shikon se si stërviten dhe në çfarë kushtesh, shqetësimi ynë rritet. Ende nuk kemi një tapet për stërvitje por përdorim një dyshek. Trajtimi i mundësve edhe pse kampion prej disa vitesh vlen shumë për të dëshiruar. Kemi kërkuar por këmbanat kanë rënë në vesh të shurdhër. Të trajtohen mundësit kampion me tremijë lek të reja në muaj besoj se nuk do shumë koment. Megjithatë ne jemi munduar të punojmë në atë mënyrë që të nderojmë ekipin e "Korabit" jo vetëm në kampionate brenda vendit por dhe jashtë tyre dhe jemi të bindur se me mundësi të talentuar dibranë edhe Federata e mundjes shqiptare do të mburret se gjithmonë në çdo kampionat ku të jemi do të ngrejme lart flamurin e kombit tonë. Qysh tani ekipi i mundjes ka filluar pregaditjet e vazhdueshme për vitin 2008 ku dhe aktivitetet janë më ngjeshura. Federata shqiptare e mundjes do të ketë aktivitetet në Francë, Serbi, Bullgari Zvicër, Poloni, Greqi, Itali, Maqedoni, Sllovaki, Turqi, si dhe Lojrat Olimpikë në Kinë. Për të gjitha këto aktivitetet tepër të ngjeshura që janë gjatë vitit 2008 ekipi i mundjes së "Korabit" ka filluar pregaditjet intensive qysh tani. - Jemi të bindur se do të përfaqësohemi në të gjitha këto aktivitetet, thotë Fiqiri, bile dhe në Lojrat Olimpikë në Pekin më 12 deri në 21 gusht të vitit 2008. Ishte surprizë kur këto ditë të ftohta kur gjatë stërvitjes së ekipit të mundjes erdhi dhe veterani i mundjes 77 vjeçari nga Ostreni i Gollobordës Rifat Duka. Megjithatë ka kohë që e ka lënë tashmë sportin e mundjes ku ka dalë disa herë kampion Rifati është nostalgjik për mundjen dhe në veçanti për ekipin e "Korabit". Kjo vizitë e papritur si dhe këshillat shumë me vlera për të rinjtë që stërviteshin ishte si një shtysë mjaft e mirë për të ecur kështu siç kanë ecur gjithmonë. Por nuk mjafton që ekipin e mundjes së "Korabit" ta vizitojnë herë pas here pensionistët, veteranët e mundjes. Këtu duhet të vijin edhe vetë pushteti lokal dhe ta shikojnë me sy realitetin se në çfarë kushtesh stërviten këto të rinj që nesër do të nderojnë jo vetëm veten por gjithë Dibrën në aktivitetet kombëtare që do të zhvillohen. Por deri tani kanë pritur vetëm medaljet që kanë sjellë, më vonë ndoshta do të kujtohen edhe pushteti lokal se ekziston një ekip mundje në Peshkopi që i ka nderuar gjithmonë dibranët. Ndoshta, ndaj le të presim.



## THIRRJE

ES-SELAMU ALEJKUM UE  
RAHMETULL-LLAHI UE  
BEREKATUHU

Të nderuar besimtarë dibranë!

Ndërtimi i xhamisë së re po përfundon. Sponsorizues Gani Abdul Naser ka investuar vetëm ndërtimin e objektit. Xhamia do të ketë: Mëdrese, bibliotekë, sallë kompjuteri, zyra si dhe salla për takime, simpoziume e mbledhje.

Pajisjet e këtyre ambienteve janë të domosdoshme prandaj kërkojmë mndihmën tuaj për t'i plotësuar me tapete, tavolina, karrike, perde, aparate foto-kopjeje, televizor etj.

Për këtë punë është ngritur një komision i përbërë nga besimtarë të besuar dhe të sinqertë: Muis Kurtulla, Mefat Shehu, Muhamet Shehu, Ylber Torba, Mendu Lusha, Albert Kojku, Shukri Torba, Halil Gazidede, Avni Gazidede, Ajet Çipuri, Sakip Rama dhe Osman Xhili.

Lekët do t'i dorëzohen vetëm Administratorit Mefat Shehu i cili do të japë mandat-arkëtimin me numër date e vulën e Myftinës Dibrë.

Lekët mund të derdhen edhe në numrin e llogarisë të myftinisë Dibrë 0002725076 në Raiffeisen Bank Peshkopi. Me titull për "Xhaminë e re".

Emrat e kontribuuesve do të afishohen në xhaminë e vjetër, dhe do të jepen dhe në Televizionin "Dibra Vision".

Myftinia do t'u informojë për çfarë janë shpenzuar këto të ardhura.

"Ndihamë për xhaminë, çezmat, rrugët etj., bëhen siguri për personat që japin".

Kjo ndihmë kurrë nuk e pakëson pasurinë tuaj, por e shton me dhjetëfish.

Es-Selamu alejkum  
Myftinia Dibrë